ZBARDHET MISTERI

Policia holandeze: Festim Laton e vranë dhe e hodhën në kanal

Konfirmohet ekzekutimi i presidentit të vetëshpallur të Republikës së Çamërisë, trupi vjen sot në Shqipëri, nesër homazhet në Vlorë

► FAQE 8

LISTA E PARË

Zhbllokohet Kushtetuesja, katër kandidatët e parë për gjashtë vende vakante

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi publikon listën e parë të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si do përzgjidhen

► FAQE 2

NGA ADRIATIK DOÇI

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI IX - NR. 176 (2698) | E PREMTE, 26-07-2019 | www.shqiptarja.com

VENDIMI I QEVERISE

JA SA DO TE JETE QIRAJA PER T'U STREHUAR NE BANESA SOCIALE

Zbardhet VKM-ja e djeshme e Këshillit të Ministrave. Kriteret dhe përjashtimet, si llogariten kostot për shtëpitë e reja dhe ato jashtë funksionit

► FAQE 11

BETEJA PER TEATRIN

PD nënshkruan me artistët: Sa të vijmë në pushtet do rrëzojmë ligjin

Kryeministri Rama: Opozita ishte edhe kundër stadiumit, bulevardit dhe pazarit të ri. Aktori Artan Imami: Marrëveshja me PD është qesharake, duhet teatër i ri

► FAQE 4-5

ANALIZA

Tallashi dhe algat si diversion ndaj problemeve të vërteta

NGA EOL ÇASHKU

► FAQE 14

GREMINGER NE TIRANE

Sekretari i OSBE-së: Duhet dialog mes palëve për zgjidhjen e krizës

► FAQE 7

FINANCAT

Borxhi publik në fund të 6-mujorit sa 63.03% e PBB-së

Në tre muajt e fundit detyrimi i shtetit është ulur 1 mln euro çdo ditë

► FAQE 10

NGA GENC KONDI

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

"Bursa dhe tarifa të përgjysmuara edhe në vitin e ardhshëm"

Ministrja e Arsimit Besa Shahini sqaron studentët gjatë ceremonisë së prezantimit të 223 të punësuarve

► FAQE 13

AKSIDENTI NE TIRANE

Shpërthen transformatori, vdes punonjësi, plagosen dhe dy të tjerë

► FAQE 12

Cyan magenta yellow black

Zhbllokohet Kushtetuesja, 4 kandidatët e parë për 6 vende vakante

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi publikon listën e parë të kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

Adriatik Doçi
TIRANE

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka hapur rrugë dje plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, boshatisja e të cilës për shkak të veprimit të ligjit të Vetingut, është kthyer në 'mollë sherri' mes opozitës dhe mazhorancës. KED ka publikuar ditën e djeshme listën e parë me katër kandidatë për gjashtë vende vakante në Kushtetuese, të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi. Pjesë e listës së parë për t'u bërë pjesë e Gjykatës Kushtetuese është këshilltarja ligjore në Gjykatën Kushtetuese, Arta Vorpsi, e cila është kualifikuar për vendet vakante të shpallura nga Presidenti në datat 7 korrik 2018 dhe 4 mars 2019, si dhe për vendet vakante të shpallura nga Kuvendi në datat 12 shkurt 2018 dhe 4 mars 2019. Kandidati tjetër është prokurori i Krimeve të Rënda, Besnik Muçi, i cili është kualifikuar si kandidat për vendi vakant i shpallur nga Presidenti në 7 korrik 2018 dhe nga vendi vakant i shpallur nga Kuvendi në 13 shkurt 2018. Fiona Papajorgji, këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese, është shpallur kandidate për t'u bërë pjesë e kësaj gjykate, për vendet vakant të shpallura nga Presidenti në 7 shkurt 2018 dhe 4 mars 2019 si dhe për vendit vakant të shpallur nga Kuvendi po në 4 mars 2019. Kandidatja e katërt është Regleta Panajoti, e kualifikuar për vendin vakant të shpallur nga Presidenti në 7 shkurt 2018. Ndërkaq, KED ka përjashtuar nga gara Anila Gurin, Dedë Kasnecin, Ilir Mustafajn, Mimoza Qinamin dhe Vladimir Gërmenjin. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi po verifikon edhe kandidatët e tjerë nëse plotësojë apo jo kushtet për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Kur të plotësohen tre kandidatë për çdo vend vakant të shpallur, KED do t'u dërgojë për votim emrat Kuvendit dhe Presidentit. Në mbledhje e radhës, KED të vendosë lidhur me lejimin ose ndalimin e kandidimit e kandidatëve Elsa Toska dhe Gëzim Allaraj në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, si edhe për kandidaten Eris Hysi për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shtyhen për mbledhjen e radhës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, tre nga Presidenti dhe tre nga Gjykata e Lartë, pas verifikimit dhe me propozim të KED. Aktualisht janë 8 vende vakante në Kushtetuese, e cila ka mbetur vetëm me një anëtare, Vitore Tushës, të cilës i ka mbaruar mandati, por që mund të qëndrojë në detyrë deri kur të zëvendësohet.

EMRAT E PËRJASHTUAR PËR TË KANDIDUAR
ANILA GURI
DEDË KASNECI
ILIR MUSTAFAJ
MIMOZA QINAMI
VLADIMIR GËRMENJI

Zhbllokimi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka publikuar ditën e djeshme listën e parë me katër kandidatë për gjashtë vende vakante në Kushtetuese, të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi.

KANDIDATËT E KUALIFIKUAR PËR 6 VENDE VAKANTE NË KUSHTETUESE
1. Arta Vorpsi, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
2. Arta Vorpsi, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
3. Arta Vorpsi, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;
4. Arta Vorpsi, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;
5. Besnik Muçi, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
6. Besnik Muçi, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
7. Besnik Muçi, për vendin vakant, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
8. Fiona Papajorgji, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;
9. Fiona Papajorgji, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;
10. Regleta Panajoti, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
11. Regleta Panajoti, për vendin vakant, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

Procesi

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi po verifikon edhe kandidatët e tjerë nëse plotësojë apo jo kushtet për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Kur të plotësohen tre kandidatë për çdo vend vakant të shpallur, KED do t'u dërgojë për votim emrat Kuvendit dhe Presidentit.

ZGJEDHJA E TRE ANËTARËVE NGA PRESIDENTI

Presidenti i Republikës ka një rol formal dhe figurativ në zgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kreu i shtetit është i detyruar që për çdo vend vakant në Gjykatën Kushtetuese të zgjedhë një emër mes tre emrave të parë në listën e renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Nëse Presidenti refuzon që ta ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 ditëve, kandidati i renditur në krye të listës konsiderohet i emëruar. Procedura e emërimit parashikohet në nenin 7/b të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ndryshuar në vitin 2016. Pika 4 e nenit 7/b parashikon që "Presidenti brenda 30 ditëve nga marrja e listës prej Këshillit të Emërimeve në Drejtësi emëron gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Dekreti i emërimit shpallet i shoqëruar me arsyet e përzgjedhjes së kandidatit. Nëse Presidenti nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar".

ZGJEDHJA E TRE ANËTARËVE NGA KUVENDI

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i dërgon Kuvendit një listë me kandidatët e renditur sipas meritës si në rastin e Presidentit. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, sipas renditjes, brenda një afati të arsyeshëm, organizon seancat dëgjimore me kandidatët. Pas këtyre seancave, Komisioni i dërgon Kuvendit emrat e tre kandidatëve për çdo vend vakant bashkë me raportin e arsyetuar për secilin kandidat të përzgjedhur. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen me tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.

KANDIDATËT PËR INSPEKTORIN E LARTË TË DREJTËSISË

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kualifikuar gjyqtarin Artur Malaj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa ka përjashtuar nga gara Altin Hazizajn dhe Mimoza Qinamin. Malaj është kualifikuar në detyrë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, organi bazë i Vetingut, por Komisioneri Publik e ka ankimuar këtë vendim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, duke kërkuar shkarkimin e tij nga detyra. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi nga radhët e kandidatëve të përzgjedhur dhe të renditur nga Këshilli për Emërimet në Drejtësi.

PROCESI I PËRZGJEDHJES

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka sqaruar se kandidatët janë verifikuar në mënyrë rigoroze dhe të thelluar. "Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve për vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë është vendosur në përfundim të procedurave të verifikimit rigoroz dhe të thelluar të ndjekura nga Këshilli, sipas ligjit dhe standardeve tashmë të njohura e të aplikuara që kërkohen për përzgjedhjen, qenien dhe konfirmimin në detyrën e magjistratit apo anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vlerëson se është rasti për të përshëndetur dhe falënderuar për përgjegjshmërinë, korrektësinë dhe shpejtësinë, në dhënien e përgjigjeve dhe sjelljen e informacioneve të plota dhe profesionale të kërkuara nga shumica dërmuese e institucioneve publike dhe subjekteve private", ka sqaruar KED.

21 kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë, si do përzgjidhen

Kandidatë edhe Theodhori Sollaku dhe Sokol Sadushi, si do të zgjidhen anëtarët e Gjykatës së Lartë, sot vendimi për fatin e Xhezair Zaganjorit

Pas Gjykatës Kushtetuese, avancon procesi edhe për zhbllokimin e Gjykatës së Lartë. Shqiptarja.com dhe Report Tv kanë zbardhur listën e plotë me emrat e juristëve, të cilët kanë kandiduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për t'u bërë anëtarë të Gjykatës së Lartë. Gara e çelur më 9 korrik 2019 u mbyll pardje, ndërsa dje është zbardhur lista e plotë me 21 kandidatët jo gjyqtarë për Gjykatën e Lartë. Pjesë e listës janë edhe ish-kryeprokurori Theodhori Sollaku si dhe kreu i Shkollës së Magjistraturës Sokol Sadushi. Në ditët në vijim Këshilli i Lartë i Drejtësisë do të kryejë verifikimin e kandidatëve sipas ligjit, duke renditur më pas një listë me kandidatët e kualifikuar. Lista do t'i dërgohet Presidentit për miratim. Sipas Kushtetutës, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Presidenti, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Aktualisht, Gjykata e Lartë ka mbetur me dy anëtarë, kryetarin Xhezair Zaganjori dhe anëtarin Ardian Dvoranin. Këtij të fundit i ka mbaruar mandati që në vitin 2014, por që sipas ligjit mund të qëndrojë në detyrë deri kur të zëvendësohet. Ndërkaq, Komisioneri Publik i ka kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelimit që të shkarkojë nga detyra kryetarin Xhezair Zaganjorin, me argumentin se nuk justifikon pasurinë. Kolegji i Apelimit do të vendosë sot për fatin e Zaganjorit. "Komisioneri Publik kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 24.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Xhezair Zaganjori. Subjekti i rivlerësimit Xhezair Zaganjori kundërshtoi konkluzionet e Komisionerit Publik, duke deklaruar se të gjitha të dhënat, faktet, rrethanat, provat e reja të depozituara prej tij gjatë procesit, i kundërpërgjigjen të gjitha shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik. Trupi gjykues pasi dëgjoi konkluzionet përfundimtare, vendosi të shpallë vendimin përfundimtar ditën e premte, më 26 korrik 2019, ora 11.00", thuhet në një njoftim të Komisionerit Publik.

LISTA E PLOTË E KANDIDATËVE JO GJYQTARË PËR GJYKATËN E LARTË

SERGJIO MAZREKU
NDUE PJETRA
ERGYS MISHA
JETMIRA RRAGAMI
ALDONA SULAJ
JORDAN DACI
LINDITA TROJA
ALMA LOCI
HERMINA ALBUNESA
REZARTA MELO
AGRON LAMAJ
ERVIN PUPE
THEODHORI SOLLAKU
IRENA NINO
VJOSA BODO
SHAQIR HASANAJ
KESTRIN KATO
SOKOL SADUSHAJ
ILIR PANDA
ARDITA BUNA
ANTON LLESHAJ

Gjykata e Lartë

Zbardhet listën e plotë me emrat e juristëve, të cilët kanë kandiduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për t'u bërë anëtarë të Gjykatës së Lartë. Pjesë e listës janë edhe ish-kryeprokurori Theodhori Sollaku si dhe kreu i Shkollës së Magjistraturës Sokol Sadushi.

Emërimi

Presidenti, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë.

Miratohen rregullat dhe kushtet për zgjedhjen e vartësve të ILD

Kuvendi i Shqipërisë me propozim të Këshillit për Emërimet në Drejtësi do të zgjedhë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Më pas drejtuesi do të zgjedhë një pjesë të inspektorëve. Në mbledhjen e djeshme të qeverisë janë miratuar rregullat se si do të zgjidhen inspektorët dhe filtrat që duhet të kalojnë më parë. Vendimi përcakton rregulla më të hollësishme lidhur me procedurat që Inspektori i Lartë i Drejtësisë (Inspektori) zhvillon për verifikimin e figurës e të pasurisë, si edhe të kushteve e të kritereve të tjera ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët jomagjistratë për t'u zgjedhur në pozicionet vakante për inspektorë.

Precedenti

Ministria e Drejtësisë vlerëson mbështetjen e EURALIUS për reformën

Ministria e Drejtësisë ka vlerësuar misionin EURALIUS në Shqipëri, duke çmuar kontributin e ofruar për implementimin dhe konsolidimin e reformës në drejtësi sipas standardeve evropiane. Përmes një postimi në rrjetin social Facebook, zëvendës ministria Fjoralba Caka ka përcjellë disa nga detajet e takimit në Ministrinë e Drejtësisë ku u prezantuan rezultatet e planit të punës për gjashtë mujorin e parë të vitit si dhe u miratua ai për gjashtëmujorin e dytë. Nisur nga vlerësimet që EURALIUS i bëri Ministrisë së Drejtësisë për rolin që po luan mbi reformimin e sistemit, Caka i ka shprehur mirënjohjen duke bërë edhe një bilanc të mbështetjes që ekspertët ndërkombëtarë kanë dhënë për ta bërë këtë projekt funksional. "Sot, në takimin e tretë të Komitetit Drejtues të EURALIUS, u prezantuan rezultatet e Planit të Punës për 6 mujorin e parë të vitit dhe u miratua plani i punës për 6 mujorin e dytë. Ministria e Drejtësisë vlerëson kontributin tejet profesional të EURALIUS V, të mbështetur edhe nga IRZ dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, si dhe asistencën e padiskutueshme të përfaqësuesve të Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe aktorëve të tjerë institucionalë shqiptarë në kuadër të reformës në drejtësi. Gjatë 6 mujorit të parë të 2019 EURALIUS ka mbështetur institucionet shqiptare me hartimin e 2 ligjeve dhe 31 akte nënligjore, ka mundësuar 17 komente, 33 raporte ekspertize dhe 20 opinione ligjore, sikurse edhe ka dhënë kontribut me 57 punime, 13 sesione trajnimi dhe 12 aktivitetet me 294 pjesëmarrës. Këto janë tregues të qartë dhe të pamohueshëm të punës së palodhur që ky mision ka marrë përsipër që prej fillimit të aktivitetit të tij në Shqipëri", shkruan Caka.

DEBATI

Bllokimi i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese për shkak të veprimit të ligjit të Vetingut, përdoret si argument nga opozita dhe Presidenti për të sulmuar reformën në drejtësi. Sipas PD, LSI dhe Ilir Metës, mazhoranca dhe ndërkombëtarët kanë asgjësuar këto dy gjykata. Ndërkaq, përfaqësuesit e SHBA-BE në Tiranë shkarkimin e anëtarëve të dy gjykatave në fjalë e kanë lexuar si sukses të reformës në drejtësi, me argumentin se Gjykata e Lartë dhe Kushtetuese ishin të kapura nga korrupsioni.

PD nënshkruan me artistët: Sa të vijmë në pushtet do rrëzojmë ligjin

Basha tek teatri: 30 qershori dita e një zgjimi të madh kombëtar, do nënshkruajmë marrëveshje edhe me grupet e tjera të interesit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA PËR TEATRIN

DEKLARATË [KONTRATË]
PËR NDËRMARRJEN E NJË ZOTIMI TË PËRBASHKËT PUBLIK

Në Tiranë, sot më 25 Korrik 2019,

Ne, **qytetarët dhe artistët e angazhuar për mbrojtjen e Teatrit Kombëtar**,

dhe **Partia Demokratike e Shqipërisë**,

1.1. Duke e konsideruar ndërlesën e Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Eksperimental, si dhe zonën përreth tij, si pjesë të patjetërsueshme të Qendrës Historike të Tiranës, si dhe me vlera të padiskutueshme historike dhe pjesë të trashëgimisë kulturore;

1.2. Duke qenë krenarë dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe me përgjegjësinë për të ruajtur trashëgiminë tonë historike e kulturore dhe mbrojtur e forcuar vlerat shpirtërore të vendit;

1.3. Duke i vlerësuar si antikombëtare dhe të palejshme përpjekjet për shkatërrimin e ndërtesës historike të Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Eksperimental;

1.4. Duke mbajtur në konsideratë se rendi kushtetues, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, janë bazat e shtetit shqiptar, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë;

1.5. Duke vlerësuar nevojën urgjente që ka arti dhe kultura për më shumë mbështetje financiare nga Buxheti i Shtetit, ndërtimin e ambienteve të reja në funksion të artit dhe kulturës, si dhe nevojën që ekziston për ruajtjen dhe restaurimin e plotë të ndërtesës së Teatrit Kombëtar;

1.6. Duke qenë të ndërgjegjshëm se pronat publike janë pasuri e të gjithë qytetarëve, dhe se nuk mund të tjetërsohen, duke cenuar interesin publik, për qëllime fitimi nga biznesi privat;

1.7. Duke e konsideruar miratimin e një ligji të posaçëm për të rregulluar procedurën për realizimin e një projekti publik-privat, konkret dhe individualisht të përcaktuar, si një precedent të rrezikshëm për interesin publik dhe që rrezikon thelbësisht barazinë përpara ligjit dhe lirinë ekonomike;

1.8. Duke mbajtur në konsideratë se mbrojtja e interesit publik dhe e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, si dhe duke qenë të ndërgjegjshëm se

DEKLARATË PËR NDËRMARRJEN E NJË ZOTIMI PUBLIK — KORRIK 2019

Pas marrjes në pyetje nga prokurorët belgë, kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka shkuar dje tek Teatri Kombëtar për të nënshkruar marrëveshjen e njoftuar një ditë më parë me Aleancën për Mbrojtjen e Teatrit. Basha është pritur me duartrokitje nga të pranishmit në sallë. Ata kanë vijuar thirrjet 'Rama ik'. Pas pritjes, Basha dhe aktorë të Teatrit Kombëtar nënshkruan marrëveshjen. Në disa pika të kësaj marrëveshjeje thuhet se një muaj pas ardhjes në pushtet të PD do të shfuqizohet ligji për shembjen e Teatrit dhe ky i fundit do të shpallet monument kulture. "Brenda një muaji nga marrja e qeverisjes PD do të shfuqizojë ligjin për shembjen e teatrit. PD do të ndërmarrë masat për të vënë para përgjegjësisë ligjore dhe penale të gjithë ata që janë përfshirë në çështjen e teatrit", parashikon marrëveshja.

BASHA

Gjatë fjalës së tij pas nënshkrimit të marrëveshjes, Basha u ndal tek zgjedhjet e 30 qershorit, ndërsa akuzoi qeverinë se ka vëtëm një projekt, atë të vjedhjes dhe pastrimit të parave të pista. "Nënshkrimi i kësaj kontrate besimi midis opozitës së sotme me atributet që, nesër, qytetarët shqiptarë do t'i japin me votën e lirë dhe të ndershme, është akti i parë që ne ndërmarrim për mbrojtjen e interesit publik. Është akti i parë që ne ndërmarrim për futjen e vendit në shinat e Kushtetutës dhe të ligjit, drejtësisë së barabartë për të gjithë, të ndëshkimit të politikanëve të inkriminuar dhe të korruptuar, pra, për dhënien fund pandëshkueshmërisë së krimit dhe korrupsionit, të garantimit të përfaqësimit të qytetarëve në parlament dhe në qeverisje të vendit dhe të politikave të zhvillimit ekonomik, të punësimit dhe të luftës kundër varfërisë. Koha për fjalë me të vërtetë ka mbaruar. 30 qershori është dita e një zgjimi të madh kombëtar.

Refuzimi popullor dhe qytetar i këtij regjimi, i cili, njësoj si tek Teatri Kombëtar, ka vetëm një projekt: grabitjen, vjedhjen, pastrimin e parave të pista të krimit, këtë projekt ka kudo. Këtë projekt kishte tek Unaza e Re, këtë projekt ka tek stadiumi, këtë projekt ka tek koncesioni më i fundit Milot – Balldre dhe që nga koncesionet e para të check up". Tha Basha.

KONTRATA TË TJERA

Kreu i PD Lulzim Basha tha gjatë fjalës së tij se do të nënshkruajë marrëveshje edhe me grupet e tjera të interesit. "Ne jemi të vendosur t'i japim fund këtij modeli. Ashtu siç zotohemi në këtë kontratë të gjurmojmë çdo qindarkë, çdo pasuri të tjetërsuar të qytetarëve shqiptarë dhe publikut shqiptar ta konfiskojmë dhe t'ia kthejmë të zotit, që është populli, janë qytetarët, janë taksapaguesit dhe pronarët legjitimë të pasurive tona publike. Por e dimë që kjo nuk mjafton. Mesazhi i 30 qershorit është mesazh për një ndryshim të vërtetë, të thellë dhe të qëndrueshëm. Për këtë arsye kontratat tona me të gjithë grupet interesit do të jenë ndërmarrja më transparente, më konkrete dhe e drejtpërdrejtë, të cilin e lidhim me vetëdijen e plotë, duke mirëpritur atë që tha Edmond Budina, që shkelja e kësaj kontrate na ngarkon me përgjegjësi direkte para publikut, para qytetarëve dhe para votuesve shqiptarë", pohoi Basha.

Kulluri:

Për tradhtitë e Bashës e ka fajin Rama e ndërkombëtarët!

Ish-anëtari i Këshillit Kombëtar të PD-së Edvin Kulluri, një ze mjaft kritik ndaj kryedemokratit Lulzim Basha vijon qëndrimin kundër tij. Kulluri thotë se disa të vërteta vazhdojnë të thuhen përgjysmë. Ai thotë se Basha nuk hyri nuk zgjedhje duke i lënë PS-së 61 bashki në tavolinë, duke e quajtur atë mjeshtër të tradhtive. "Vazhdojnë të thuhen të vërteta përgjysmë! Pse PD nuk caktoi emrat e vet për anëtarë të KLP dhe KLGJ, por ia la të gjitha propozimet PS për këto organe?! Kush i votoi në Kuvend 6 ligjet e Reformës në Drejtësi pa konsensusin e PD?! LSI dhe PDIU. Kujt i ankohen të tre partitë e mëdha të opozitës për këto organe si të kontrolluara nga Rama dhe reformën si te njëanshme?! Nëse nuk ke moral për diçka, mos bërtit se ke të drejtë?! Po në Reformën Territoriale pse nuk mori pjesë PD?! Pse e la në mes Basha aksionin për referendume në bashkitë dhe komunat që drejtonte opozita?! Kush bëri marrëveshje dhe lista deputetesh idioteske dhe të pabesa në 2017?! Po në zgjedhje lokale kush nuk hyri duke i lënë PS 61 bashki në "tavolinë"?! Kush dhe kujt i ankohen për ndarje politike administrative dhe "diktaturën" e pushteteve në dorë të Ramës?! Për tradhtitë e Bashës e ka fajin Rama dhe ndërkombëtaret?", shkruan Kulluri.

Pjesë nga marrëveshja mes PD dhe Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit

1-Lidhur me Teatrin, aleanca shpreh gatishmërinë për të mbrojtur atë. PD dhe opozita angazhohen për mbrojtjen e tij duke përfshirë ndërmarrjen e çdo aksioni të mundshëm. Brenda një muaji zonën ku përfshihet edhe teatri kombëtar do t'i rikthehet statusi monument kulture. Ai do t'i nënshtrohet restaurimit sipas ekspertëve të kulturës. Brenda një muaji nga marrja e qeverisjes PD do të shfuqizojë ligjin për shembjen e teatrit. PD do të ndërmarrë masat për të vënë para përgjegjësisë ligjore dhe penale të gjithë ata që janë përfshirë në çështjen e teatrit.

2-Lidhur me masat për të garantuar rendin publik, kur PD të vijë në pushtet do të garantojë që çdo investim do t'i kthehet publikut nëpërmjet konfiskimit. PD do ndërmarrë çdo veprim ligjor të mundshëm që çdo subjekt privat që ka punuar për dëmtimin e pronës publike do detyrohet të paguajë dëmshpërblimin. PD angazhohet të nisë një reformë ligjore për rritjen e gjithë përfshirjes së vendimmarrjes në çështjet me interes publik. Diskutimi mbi këto çështje duhet të bëhen në mënyrë transparente. Brenda një viti nga ardhja në pushtet e opozitës do nisë decentralizimi i institucioneve kulturore. Reformimi i kuadrit ligjor për statusin e artistit. Për këtë qëllim palët janë mirëkuptuar për të punuar së bashku. Ato angazhohen të konsultohen me njëra tjetrën'.

Kontrata

Neritan Liçaj flet pas nënshkrimit të marrëveshjes, përdor moton e opozitës

Pas nënshkrimit të kontratës me Partinë Demokratike, aktori Neritan Liçaj ka mbajtur fjalën e tij duke e quajtur marrëveshjen një lëvizjes qytetare për kombin dhe flamurin. Gjatë fjalës së tij, Liçaj përdori edhe moton e opozitës duke thënë 'E duam Shqipërinë si e gjithë Evropa'. "Kjo mbetet një lëvizje qytetare, për kombin dhe flamurin. Kemi qenë student të dhjetorit dhe fati solli që të përmbyllim atë detyrë të nisur. Sa herë dëgjoj 'E duam Shqipërinë si e gjithë Evropa' më kujtohen ato kohë. Jemi 30 vite pas edhe ende nuk e kemi arritur. Pas 30 vitesh nënshkruam një pakt njerëzor", tha Liçaj.

Nënshkrimi

Pas marrjes në pyetje nga prokurorët belgë, kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha ka shkuar dje tek Teatri Kombëtar për të nënshkruar marrëveshjen e njoftuar një ditë më parë me Aleancën për Mbrojtjen e Teatrit.

Marrëveshja

"Brenda një muaji nga marrja e qeverisjes PD do të shfuqizojë ligjin për shembjen e teatrit. PD do të ndërmarrë masat për të vënë para përgjegjësisë ligjore dhe penale të gjithë ata që janë përfshirë në çështjen e teatrit".

TEATRI / EDMOND BUDINA DYSHUES PËR MARRËVESHJEN

Artan Imami: Marrëveshja me PD është qesharake, duhet teatër i ri

Aktori i njohur Artan Imami ishte dje në studion e Report Tv ku foli për marrëveshjen e nënshkruar nga PD dhe Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit. Imami tha se kjo marrëveshje është tërësisht qesharake, duke i mëshuar idesë se duhet një teatër i ri. "Marrëveshja është tërësisht qesharake, pasi sot duhet një teatër i ri. Projekti për teatrin tashmë është duke u negociuar. Jemi në pritje të ofertave që do të vijnë nga privatët. Ne kemi kërkuar më shumë, jo salla me 150 vende. Mbaruan fjalët, diskutimet dhe mallkimet. Fitoi ajo palë që kishte një argument më shumë. Ata duhet të bashkohen me ne. Ata që ia vlejnë. Merri një për një me emër ata dhe do shohësh që do zhgënjehesh. Ky është momenti kur përballë kemi ata që duhet të zbatojnë detyrën. Kjo bëhet me njerëz që duhet të bëjnë punën e tyre. Çdo grupim i ndershëm dhe i papolitizuar. Kjo opozita mirë që është hedhur në një pishinë pa ujë dhe pastaj thonë o koka. Hidhen me parashutë dhe kur e kuptojnë se nuk dine të fluturojnë duan të ndryshojnë ligjin e rëndesës", tha Imami. Regjisori Edmond Budina ka shfaqur anën e tij kritike lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes me PD për Teatrin Kombëtar. Budina tha se kjo kontratë nuk duhej nënshkruar nga artistët, por nga populli. "Nuk jam kundra asaj kontrate, por gjërat duhet të jenë të vërteta. Përderisa kontrata është simbolike duhej të firmosej me popullin dhe të zbatohej në vijim. Pse unë paskam më shumë të drejtë se ata të tjerët që kanë qenë çdo ditë këtu? Nëse ai nuk e zbaton ne do jemi kundër. Në këtë situatë që është Shqipëria kam besim. Jam i mendimit se ndërrimi i pushteteve lë vend për ndryshim", tha Budina.

Imami
"Marrëveshja është tërësisht qesharake, pasi sot duhet një teatër i ri. Projekti për teatrin tashmë është duke u negociuar. Jemi në pritje të ofertave që do të vijnë nga privatët".

RAMA
'Zoti u shtoftë inatin, që të na shtojnë takatin", ju uroj një ditë të mbarë. Nisi kundër këndit të lojërave, pastaj kundër sheshit Skënderbej, kundër pazarit të ri, kundër bulevardit të ri, kundër stadiumit Qemal Stafa, sot kundër Teatrit të ri'.

BULKU
'Unë jam për një teatër të ri, dhe i qëndroj deklaratave të mia, por jo në dhunim të ligjeve, kolegëve, miqve e shokëve të mi! Respekto traditën! Ruaje historinë! Ndërto teatër të ri, jo duke shkulur të vjetrin!'

Rama: Opozita ishte edhe kundër stadiumit, bulevardit dhe pazarit të ri

Bulku i përgjigjet Ramës: Do doja të isha në protestë me kolegët! Teatër i ri por jo duke shkulur të vjetrin

Kryeministri Edi Rama reagoi lidhur me protestën politike, e cila zhvillohet prej ditës së mërkurë tek Teatri Kombëtar ku disa artistë dhe aktivistë, të mbështetur nga forcat politike të opozitës, kundërshtojnë ndërtimit e një teatri të ri dhe bashkëkohor. Rama sjell në vëmendje rastet e tjera të protestave të opozitës që kanë kundërshtuar ndërtimin e projekteve të tjera që i kanë dhënë një fytyrë të re kryeqytetit. "Mirëmëngjesi dhe me atë shprehjen popullore, "Zoti u shtoftë inatin, që të na shtojnë takatin", ju uroj një ditë të mbarë. Nisi kundër këndit të lojërave, pastaj kundër sheshit Skënderbej, kundër pazarit të ri, kundër bulevardit të ri, kundër stadiumit Qemal Stafa, sot kundër Teatrit të ri", shkruan Rama. Në një tjetër reagim, kryeministri Edi Rama ka ironizuar qëndrimin e opozitës lidhur me çështjen e teatrit . Ai ka shpërndarë një shprehje të Paulo Coelhos e cila thotë se disa persona jetojnë në luftë me të tjerët dhe veten dhe për këtë arsye shprehin vepra teatrale duke i përshtatur me sikletet e tyre. "Disa persona jetojnë vazhdimisht në luftë me të tjerët, me vetveten, me jetën e tyre! Për këtë arsye shpikin vepra teatrale imagjinare, skenarin e të cilave e përshtasin me sikletet e tyre. Paulo Coelho", shkruan Rama. Kryeministri bëri një reagimin e tretë

brenda ditës në lidhje me protestën politike të artistëve mbështetur nga PD dhe LSI kundër ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar mbi rrënojat e të vjetrit. Kreu i qeverisë përmes një postimi në Facebook, solli në vëmendje një deklaratë të aktores së mirënjohur Rajmonda Bulku, njëherazi ish-deputete e Partisë Demokratike, e cila thotë se nuk ka asnjë dyshim që godina e teatrit duhet shembur. "Minoranca e zhurmshme dhe e verbër teatralo-politike, nuk përfaqëson asfare opinionin e shumicës së komunitetit të artistëve të skenës, për projektin e Teatrit Kombëtar! Ja çfarë mendon një aktore e njohur e skenës kombëtare, e cila jo vetëm s'ka asnjë lidhje me këtë shumicë qeverisëse, po ka qenë aktive si qytetare qysh në kohën e ndryshimeve historike dhe më pas edhe si deputete, në radhët e Partisë Demokratike: Raimonda Bulku. Aty duhet të ketë një teatër shumë të mirë, ç'më duhet mua se çfarë ndërtohet anës teatrit, apo mbi teatër. Në qiell le të ndërtohet, s'kam ndonjë gjë; unë dua të ndërtohet një teatër. Nuk ka rëndësi fare se çfarë. Godina e teatrit duhet shembur, pa dyshim. Ne po përjetojmë kushte mizerabël. Unë nuk e di se si punojmë aty, është turp të punosh aty. Tani që u gjet Turbina, shumë mirë, ajo sallë është për atë zonë, atë lagje dhe si ajo duhet të ndërtohet edhe një në Kombinat, edhe një në Laprakë, që padyshim është një lagje afër Tiranës. Unë do të dëshiroja që të ngrihet një Teatër i ri Kombëtar, me parametra të tjerë", shkruan Rama.

REAGON RAJMONDA BULKU

Rajmonda Bulku ka deklaruar pas shpërndarjes së një deklarate të saj nga kryeministri Rama, ku kërkonte ndërtimin e një teatri të ri teksa fliste për kushtet mizerabël në Teatrin aktual Kombëtar. Bulku thotë se i qëndron deklaratave të saj, por është kundër dhunimit të ligjit dhe të kolegëve të saj aktorë që po protestojnë duke mos lejuar shembjen e teatrit për ndërtimin e të riut. Teksa në deklaratën e mëparshme disa kohë më parë, Bulku shprehej: "Godina e teatrit duhet shembur, pa dyshim", në reagimin e djeshëm ajo jep një qëndrim tjetër kur thotë: "Ndërto teatër të ri, jo duke shkulur të vjetrin". Rajmonda Bulku në një postim në rrjetet sociale, thotë se do të ishte krah kolegëve të saj në këtë protestë, por ndodhet jashtë Shqipërisë pasi është bërë gjyshe dhe po kujdeset për mbesën e saj, që siç ajo shprehet, do dëshironte të bëhej aktore teatri. "Unë jam për një teatër të ri, dhe i qëndroj deklaratave të mia, por jo në dhunim të ligjeve, kolegëve, miqve e shokëve të mi! Respekto traditën! Ruaje historinë! Ndërto teatër të ri, jo duke shkulur të vjetrin! Jam larg dhe më vjen keq që mungoj të jem mes kolegësh në teatër ...! Në krahët e mi mbaj mbesën time që më mrekullon dhe dëshiroj që të bëhet aktore teatri....!", shkruan aktorja Rajmonda Bulku. Reagimi i saj u shpërnda në grupin zyrtar që Partia Demokratike shfrytëzon për komunikim me gazetarët në përcjelljen e lajmeve nga selia blu.

“Teatri do të bëhet Tiranën s’mund ta mbajë peng një minorancë”

Erion Veliaj vlerësohet në SHBA në konferencën vjetore me temë “Qytete që rriten me gjelbërim”

Teatri

Kryebashkiaku tha se ashtu siç janë kundërshtuar çdo gjë e mirë e bërë nga Bashkia e Tiranës për qytetarët në këto 4 vjet, edhe projekti i Teatrit të Ri do të zhvillohet dhe kryeqyteti do ketë një teatër modern, i cili do t’i shërbejë si aktorëve, ashtu edhe artdashësve

Qyteti nuk mund të mbahet peng nga asnjë minorancë e zhurmshme. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, nga Denveri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku mori në konferencën vjetore me temë “Qytete që rriten me gjelbërim”, në të cilën prezantoi Tiranën dhe projektet transformuese të saj, u shpreh se qyteti nuk mund të ndalet në rrugën për të ecur përpara me Teatrin Kombëtar, Unazën e Re, zgjatimin e Lanës apo Bulevardin e Ri, pavarësisht kundërshtive që mund të kenë pakica të caktuara të lidhura me politikën.

Kryebashkiaku tha se ashtu siç janë kundërshtuar çdo gjë e mirë e bërë nga Bashkia e Tiranës për qytetarët në këto 4 vjet, edhe projekti i Teatrit të Ri do të zhvillohet dhe kryeqyteti do ketë një teatër modern, bashkëkohor, i cili do t’i shërbejë si aktorëve, ashtu edhe artdashësve. “Kemi kaluar disa sfida në mandatin tonë të parë: mbaj mend këndet e lodrave, protestat kundër tyre. Edhe këtu në Amerikë shumë prej projekteve që sjellin ndryshim përshkohen nga një sens histerie, protestash apo pakënaqësie. Megjithatë, kur ndryshimi vjen, përqafohet nga të gjithë. Në Tiranë ndryshimi do të vijë edhe për çështje shumë të debatueshme, si zgjatimi i Lanës, Unaza e Madhe, Teatri i Ri Kombëtar, por janë ndryshime absolutisht të nevojshme dhe të pakontestueshme. Pra, nuk mundet që qyteti të mbahet peng prej disa minorancave që do ekzistojnë gjithmonë, dhe gjithmonë nuk do të bien dakord. Më vjen mirë se si Tirana, në aktivitetin më të madh të bashkive në SHBA, është sot imazhi i një Shqipërie moderne, i një Shqipërie që po ndryshon, që ka plot probleme, por që më e mira është përpara”, tha Veliaj.

HAPESIRAT E GJELBERTA

Duke iu referuar pikërisht temës së diskutimit të këtij takimi, kryebashkiaku u shpreh i kënaqur që Tirana është përzgjedhur si model suksesi për nismat në shtimin e gjelbërimit, duke filluar nga zbatimi i projektit të Pyllit Orbital e deri investimet në parqe, çka ka sjellë edhe një frekuentim masiv të tyre. “Jam shumë krenar për të gjitha ato që kemi arritur në Tiranë. Një nga gjërat për të cilat po shquhet Tirana janë hapësirat e gjelbërta. Sapo kemi filluar rehabilitimin e Parkut Rinia, kemi mbaruar Parkun e Liqenit, që është parku tradicional i Tiranës, por ambicia për 4 vitet e tjera është që të vazhdojmë me Parkun e Kasharit, me Parkun e Farkës. E mbi të gjitha, të vijojmë me Parkun Qendror te Bulevardi i Ri dhe parkun linear në të dyja brigjet e lumit të Tiranës. E shohim Bulevardin e Ri jo vetëm si një hapësirë të financës dhe teknologjisë, të hoteleve të ardhshme, por e shohim kryesisht të lidhur me parqet që do të ndërtohen në atë zonë”, theksoi ai.

Më tej, Veliaj nënvizoi se nisur nga mënyra se si qytetarët i kanë pritur këto ndryshime, edhe në 4 vitet e ardhshme të mandatit të dytë, shtimi i hapësirave të gjelbra dhe politikat që sjellin një mjedis të pastër, do të jenë në qendër të vëmendjes së Bashkisë Tiranë. “Njerëzit preferojnë ta kenë shtëpinë, punën, rutinën e ditës, pranë një parku dhe një hapësire të gjelbërt. Nëse do të kishte një refren ose një etiketë për 4 vitet e ardhshme të Bashkisë së Tiranës, do të ishin 4 vitet e hapësirave të gjelbërta, parqeve dhe të këndeve të lodrave. Kemi parë se si vlera e pronës është rritur aty ku ka një park. Kemi parë se si ekonomia është zhvilluar, janë krijuar më shumë vende pune, dhe do të doja shumë që reputacioni i Tiranës të ishte rreth parqeve”, shtoi Veliaj.

“QYTETE QË RRITEN ME GJELBËRIM”

Kryebashkiaku Veliaj hapi Kongresin vjetor me temë “Qytete që rriten me gjelbërim”, ku morën pjesë mbi 1.000 kryetarë bashkish dhe menaxherë qytetesh nga 200 bashki të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Kanadasë. Në vitet e fundit, takimi “Greater & Greener” ka tërhequr folës dhe liderë nga mbi 20 vende, duke përfshirë kryebashkiakun e qytetit të Nju Jork-ut, Michael Bloomberg, kryebashkiakun e San Franciskos, Ed Lee, Guvernatorin e Kalifornisë, Gavin NeWsom etj. Plani Vendor për Tiranën 2030, transformimi i Sheshit “Skënderbej” dhe fokusi tek investimet urbane për krijimin e “Pyllit Orbital” përreth qytetit, kanë tërhequr vëmendjen edhe të drejtuesve të qyteteve të tjera dhe të urbanistëve në të gjithë botën.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “REAL BAILIFF SERVICE” SH.P.K DO TË ZHVILLOJË ANKANDIN E TRETË PËR PASURITË E PALUAJTSHME:

Are, me Nr. Pasurie 36, Vol.1, Faqe 36, Zonë kadastrale 2635 me siperfaqe 1750 m², me vendodhje Mbrezhdan, Permet.
Çmimi me të cilin fillon ankandi i tretë është 126,000 (njeqind e njezete e gjashte mije) Leke,

Are, me Nr. Pasurie 269, Vol.2, Faqe 19, Zonë kadastrale 2635 me siperfaqe 549 m², me vendodhje Mbrezhdan, Permet.
Çmimi me të cilin fillon ankandi i tretë është 30,240 (tridhjete mije e dyqind e dyzete) Leke,

Pasurite janë në pronësi të Llazi Thoma Nasi dtl.01.10.1962, Vjollca Muharrem Nasi dtl.20.01.1971 dhe Vitori Kiço Nasi dtl.05.05.1928.

Mbi pasurite është vënë hipotekë ne favor te “Agrokredit” Sh.a, per Shumen prej 200,000 (dyqind mije) Leke.

Ankandet do të zhvillohet në ambjentet e shoqërisë “REAL BAILIFF SERVICE” sh.p.k, në datë 19.08.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. “Pjeter Bogdani”, Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

SOT PROVA E PARË

Betohet kryetari i ri i bashkisë së Devollit, a do e lirojë zyrën PD?

Pas shpërndarjes së mandateve të këshilltarëve nga Kolegji Zgjedhor sot në orën 11:00 do të konstituohet këshilli i parë bashkiak, i Devollit. Në mbledhjen e këshillit do të betohet kryetari i ri i bashkisë që është zgjedhur në zgjedhjet lokale të 30 Qershorit.

Ai është Eduard Duro i zgjedhur nga Partia Socialiste. Por a do ta lirojë zyrën kryetari aktual në detyrë Bledjon Nallbati i zgjedhur para katër viteve si përfaqësues i Partisë Demokratike? Nëse do t’i referohemi deklaratës së djeshme të Lulzim Bashës që u shpreh se zyrat nuk lirohen, atëherë nesër pritet që të kemi një provë force në Devoll, që është rasti i parë i rotacionit.

Presidenti dhe opozita (që i bojkotoi) nuk i njohin zgjedhjet lokale të 30 Qershorit, ndërsa SHBA dhe BE, pasi i certifikuan, kërkuan që kryetarët e rinj të bashkive që u zgjodhën të nisin punën sa më parë.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “REAL BAILIFF SERVICE” SH.P.K DO TË ZHVILLOJË ANKANDIN E DYTË PËR PASURINË E PALUAJTSHME:

“Toke Are”, me Nr. Pasurie 360/21 Volum 7, Faqe 82, Zonë kadastrale 3719, me siperfaqe 2000 m², me vendodhje Vasjar, Tepelene, në pronesi te Idajet Teme Beta dtl.28.12.1958 dhe Tajane Kaso Beta dtl.03.04.1960, mbi të cilën është vënë hipotekë në favor të “Agrokredit” Sh.a, për Shumën 300,000 (treqind mije) Leke.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i dytë është 448,000 (katerqind e dyzete e tete mije) Leke.

Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e shoqërisë “REAL BAILIFF SERVICE” sh.p.k, në datë 16.08.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. “Pjeter Bogdani”, Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “REAL BAILIFF SERVICE” SH.P.K DO TË ZHVILLOJË ANKANDIN E TRETË PËR PASURITË E PALUAJTSHME:

Are, me Nr. Pasurie 277/1, Vol.4, Faqe 82, Zonë kadastrale 2609 me siperfaqe 2890 m2, me vendodhje Mashkullore, Gjirokaster.
Çmimi me të cilin fillon ankandi i tretë është 252,000 *(dyqind e pesedhjete e dy mije) Leke.*

Are, me Nr. Pasurie 320/2, Vol.5, Faqe 163, Zonë kadastrale 2609 me siperfaqe 3644 m2, me vendodhje Mashkullore, Gjirokaster.
Çmimi me të cilin fillon ankandi i tretë është 403,200 *(katerqind e tre mije e dyqind) Leke*.

Are, me Nr. Pasurie 320/3, Vol.5, Faqe 164, Zonë kadastrale 2609 me siperfaqe 3644 m2, me vendodhje Mashkullore, Gjirokaster.
Çmimi me të cilin fillon ankandi i tretë është 176,400 *(njeqind e shtatedhjete e gjashte mije e katerqind) Leke.*

Pasurite janë në pronësi të Nafiz Sali Alikaj dtl.22.05.1965, Lumturi Nevruz Alikaj dtl.01.10.1975 dhe Desdemona Abedin Alikaj dtl.11.05.1940.
Mbi pasurite është vënë hipotekë ne favor te “Agrokredit” Sh.a, ne shumen prej 1,000,000 (nje milion) Leke.

Ankandet do të zhvillohet në ambjentet e shoqërisë “REAL BAILIFF SERVICE” sh.p.k, në datë 21.08.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. “Pjeter Bogdani”, Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE “REAL BAILIFF SERVICE” SH.P.K DO TË ZHVILLOJË ANKANDIN E PARË PËR PASURINË E PALUAJTSHME:

“Truall”, me Nr. Pasurie 7/231, Vol. 16, fq.111, Zonë kadastrale 8564, me siperfaqe 1200 m², me vendodhje Korçë, në pronesi te Daniel Godfrey Kalley dtl. 21.06.1968.

Çmimi me të cilin fillon ankandi i parë është 4,320,000 (kater milion e treqind e njezete mije) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e shoqërisë “REAL BAILIFF SERVICE” sh.p.k, në datë 07.08.2019 në orën 16:00, në adresën: Rr. “Pjeter Bogdani”, Pallati 8/1, Kati 1, Tiranë. Cel: 0698222238, e-mail: info@realbailiff.al.

LETRA / ALEANCA PËR TEATRIN I KËRKON NDIHMË OSBE-së

Teatri, Greminger: Prisni të vendosë Gjykata e Kushtetuese

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit Kombëtar i ka dërguar një letër OSBE-së në të cilën i kërkon takim me delegacionin që ka qenë sot në Tiranë për të diskutuar mbi vendimin e qeverisë për shembjen e Teatrit Kombëtar. Megjithatë një kërkesë e tillë nuk është pranuar nga sekretari i përgjithshëm i OSBE, Thomas Greminger, sipas së cilit ka pasur një axhendë të ngjeshur çka ia pamundësonte një takim tjetër. Në letër, Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, ka ngritur akuza të rënda për kryeministrin Edi Rama, ku shkruhet se si ai po përfiton nga fakti që nuk ka gjykatë Kushtetuese dhe ka "kapur" Ekzekutivin, që e tregon dhe çështja e Teatrit. "Shpronësimi i truallit publik dhe privat që rrethon Teatrin Kombëtar është bërë i mundur nga një i ashtuquajtur ligj special. Gjithçka që vjen më pas, nuk është gjë tjetër veç legalizimit të vjedhjes, e bërë e mundur falë faktit që Shqipëria nuk ka një Gjykatë Kushtetuese për të paktën dy vjet. Mungesa e një Gjykate Kushtetuese, rezultat i të ashtuquajturës 'reforma në drejtësi', i ka dhënë mundësi qeverisë të pushtojë çdo pushtet vendimmarrës në Shqipëri. Nuk e ekzagjerojmë aspak kur themi se qeverisemi nga dekretet dhe çdo vendimmarrje, sado e rëndë mund të jetë, është e lejueshme, për sa kohë që qeveria e aprovon. Z. Sekretar i Përgjithshëm, Komuniteti ndërkombëtar i ka kushtuar shuma të mëdha monetare dhe burime njerëzore për të ndërtuar një demokraci funksionale, shtet ligjor, ndarje të pushteteve dhe balancave në Shqipëri. Asnjë nga këto nuk ekziston në këtë moment dhe Ekzekutivi, i kontrolluar personalisht nga kryeministri Rama, është totalisht i shfrenuar, ashtu siç tregon edhe çështja e Teatrit Kombëtar. Ne besojmë se do ishte një gabim fatal, gabim i cili do dëmtonte besimin e publikut shqiptar ndaj institucioneve ndërkombëtare, nëse një gjendje e tillë do lejohet të vazhdojë", shkruan Aleanca e Teatrit.

Por në përgjigje të kësaj letre, Greminger thekson se të gjitha palët duhet të presin vendimin e Gjykatës Kushtetuese para se të vazhdojnë më tutje kjo çështje. "Kam marrë me kënaqësi ftesën tuaj, pasi ajo tregon konsideratë për Organizatën që unë përfaqësoj. Megjithatë, për fat të keq, për shkak të një vizite të shkurtër dhe një axhende të ngushtë, nuk isha në gjendje ti u përgjigjesha pozitivisht. Duke pasur parasysh zhvillimin e djeshëm, përkatësisht Presidentin e Republikës, duke paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me ligjin e posaçëm për ndërtimin e ndërtesës së re të Teatrit Kombëtar, të gjitha palët duhet të presin vendimin e Gjykatës së Lartë para se të vazhdojnë më tutje kjo çështje", shkruhet në përgjigjen e Greminger .

Sekretari i OSBE-së: Duhet dialog mes palëve për zgjidhjen e krizës

Greminger: Të gjithë të angazhohen për funksionimin e demokracisë në vend. Cakaj: Jemi të hapur, por pa kompromis me institucionet aktuale

Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së Thomas Greminger deklaroi gjatë një konference të përbashkët me ministrin në Detyrë për Punët e Jashtme Gent Cakaj se OSBE inkurajon dialogun mes palëve politike për t'i dhënë fund krizë e cila dëmton institucionet.

Greminger tha se në kryesinë e radhës së OSBE-së kërkon një Shqipëri të bashkuar, teksa e quajti atë një shans të mirë që vendi të angazhohet në BE. "Ne pa diskutim që ndjekim nga afër zhvillimet politike në Shqipëri. Shpresojmë që ngërçi do të zgjidhet së shpejti. Besoj se zgjidhja do të gjendet brenda për brenda por ne inkurajojmë dialogun. Është e nevojshme që të gjithë aktorët të angazhohen për funksionimin e demokracisë në vend. Pjesëmarrja në institucionet demokratike është e vetmja rrugë zhvillimi. OSBE është e gatshme për të ofruar mbështetje por asnjë zgjidhje nuk mund të jetë e qëndrueshme nëse nuk përfshihen të gjithë aktorët. Faleminderit për interesin e paraqitur. Kam ardhur për përgatitjet e kryesisë së radhës së OSBE e cila në 2020 i takon Shqipërisë. Dua të falenderoj atë që ka krijuar tonin e duhur. Më vonë gjatë ditës do te takohem me Ramën dhe Metën. Kryesia e OSBE-së nuk është një përpjekje e vogël. nuk është vetëm një sipërmarrje diplomatike por duhet të mbështetet nga i gjithë shteti shqiptar. Nuk ka dyshime që Shqipëria mund t'ia kalojë me sukses. Do jetë edhe një ushtrim frymëzues dhe besoj se do përmirësojë profilin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Nga ana tjetër është shans për komunitetin e OSBE për t'u mbështetur tek perspektiva e Shqipërisë për t'u përmirësuar. Kryesimi i mirë i OSBE do jetë një rol i veçantë për pranimin e Shqipërisë në BE. Shqipëria duhet të tregojë rolin e vet. Kryesimi i një organizate kërkon një Shqipëri të bashkuar. Shqipëria duhet të mbështetet nga sekretariati i OSBE-së. Jemi në një angazhim të përbashkët që kryesia e OSBE në 2020 të jetë e suksesshme", tha Greminger.

Në fjalën e tij ministri Cakaj tha se mazhoranca mbetet e hapur për dialog si me opozitën parlamentare dhe atë jo parlamentare por kjo nënkupton kompromis me institucionet aktuale. "Ne do të angazhohemi për të promovuar mirëqeverisjën dhe do të adresojmë përpjekjet e përbashkëta të të gjithë vendeve pjesëmarrëse për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Rinia të mos trajtohet më thjesht si një gjeneratë që vjen por që ka nevojë për forcimin e rolit të saj. Shqipëria është sot pranë momentin historik për të marrë miratimin për negociatat. Po punohet në tre dimensione, politik ku kemi prezantuar prioritetet, financiar ku Shqipëria tashmë ka ndarë buxhetin e veçantë për të përballuar të gjitha sfidat. Dhe së treti në aspektin organizativ. Nga shtatori e tutje Shqipëria do të përformojë me kapacitet të plotë. Me sekretarin e OSBE kemi hartuar një paketë për t'i shërbyer të ardhmes. Mbesim të hapur për dialog dhe jemi të gatshëm të nisim menjëherë punën me të gjitha partitë politike si me ato që janë në parlament dhe ato që kanë dalë në rrugë. Ne duhet të përbashkojmë përpjekjet në përputhje me reformën elektorale por kjo nuk nënkupton kompromis me institucionet aktuale", tha Cakaj.

VIZITA / PRESIDENTI TAKON SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË OSBE-së

Meta - Greminger: Ndërmjetësoni dialogun për zgjidhjen e krizës

Presidenti Ilir Meta priti dje në një takim sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së Thomas Greminger. Kreu i Shtetit i kërkoi Greminger ndërmjetësimin sa më parë të jetë e mundur midis palëve politike në vend për zgjidhjen e kësaj krize. Meta tha se përjekjet e tij të vazhdueshme për zgjidhjen e krizës politike janë minuar nga aktorë të ndryshëm dhe shprehu bindjes se rruga e vetme është dialogu politik dhe gjithëpërfshirës. "OSBE ka një rëndësi të posaçme për sigurinë euro-atlantike dhe për Shqipërinë në veçanti. Është organizata e parë shumëpalëshe në të cilën Shqipëria aderoi pas rënies së komunizmit dhe që ka dhënë mbështetje të vazhdueshme për forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor në vendin tonë. Për rivendosjen e funksionimit normal të institucioneve demokratike dhe shmangien e përshkallëzimit të mëtejshëm të situatës mjaft kritike ku ndodhet vendi, është në interes të kredibilitetit të OSBE, të angazhohet për tejkalimin e krizës së rëndë në Shqipëri sa më parë të jetë e mundur. Ky angazhim do të shërbejë si mundësi tepër e rëndësishme për rikthimin e vendit në shinat e demokracisë dhe sundimit të ligjit, por dhe konsolidimit të lidershipit të Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon, gjatë marrjes së Kryesisë së Rradhës së OSBE, por edhe së ardhmes europiane të Shqipërisë, për më tepër kur presim që në 17-18 tetor Këshilli i Bashkimit Europian të vendosë për çeljen e negociatave të anëtarësimit. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme dhe konkrete që kam ndërmarrë deri tani për parandalimin e kësaj situate, përpjekje që janë minuar nga aktorë të ndryshëm, jam edhe më i bindur tani se rruga e vetme është dialogu politik gjithpërfshirës dhe i sinqertë që i jep zgjidhje të plotë e përfundimtare kësaj krize", - deklaroi Presidenti Meta.

ZBARDHET MISTERI

Policia holandeze: Laton e vranë dhe e hodhën në kanal

Konfirmohet ekzekutimi i presidentit të vetëshpallur të Republikës së Shqipërisë, trupi vjen sot në Shqipëri, nesër homazhet në Vlorë

ELTON QYNO
TIRANE

Policia holandeze konfirmon ekzekutimin e Presidentit të vetëshpallur Republikës së Çamërisë, Festim Lato. Familja e Latos, ka hapur dyert e mortit, ndërsa sot në orën 15:00 do të presë në Rinas trupin e pajetë të 43-vjeçarit që u gjet i vrarë në Holandë ku jetonte prej vitesh. Festim Lato do të përcillet për në banesën e fundit me homazhe të cilat do të mbahen nesër tek "Teatri Petro" në Vlorë. Lajmi I mbritjes së trupit u konfirmua dje paradite për Report TV nga historian Eleni Kocaqi, një prej bashkëpunëtorëve të ngushtë të Festim Latos.

Nga mediat holandeze mësohet se autoritetet e drejtësisë së këtij vendi kanë konfirmuar se trupi që u gjet javën e kaluar në një kanal është i shqiptarit Festim Lato, që ishte vetëshpallur President i Çamërisë. Policia holandeze ka përjashtuar pistën e vetëvrasjes. Sipas saj Festim Lato është vrarë dhe më pas është hedhur në një kanal.

Vitet e fundit, Lato kishte qëndruar në një shtëpi në Afferden. Jashtë shtëpisë së tij duket flamuri i Holandës, Shteteve të Bashkuara dhe Çamërisë. Por në janar të këtij viti pronari e kishte larguar nga banesa, pasi kishte ankesa pasi hynin dhe dilnin shumë persona duke krijuar shqetësim. Ndërsa në prill të këtij viti Lato u deklarua zyrtarisht i falimentuar nga gjykata e Zutphen.

Më 20 korrik një lajm i shpërndarë në rrjetet sociale nga miq Festim Latos, president të vetëshpallur të Republikës së Çamërisë, alarmoi jo vetëm autoritetet në Shqipëri, por edhe në Holandë, ku vlonjati jetonte prej vitesh. Një 44-vjeçar i larguar në moshë të vogël nga Shqipëria, por që jeta e tij ndryshoi tërësisht duke filluar një jetesë luksoze në Holandë. Lajmi mbeti për shumë orë i shpërndarë vetëm në rrjetet sociale, ndërsa shumë më vonë, edhe mediat holandeze nisën të përmendin emrin e Festim Latos, si personin që u gjet i vdekur të shtunën pasdite përgjatë Nieuwwe Ubbergseweg.

Ditët e para, as familja e tij nuk e kishte të sigurt nëse personi i gjetur i vdekur ishte apo jo Festim Lato. Nga autoritetet në Shqipëri nuk u dha asnjë detaj, ndërsa dhe vetë ambasada shqiptare në Holanda siç u shpreh për Shqiptarja.com ditë më parë, kishte informacione konfuze nga autoritetet atje. Dyshimet mbi vërtetësinë e lajmit janë ngritur nga mediat holandeze pasi sipas tyre Lato kishte borxhe me kompani dhe individë që shkonin deri në miliona euro, linte dyshime për një vdekje të stisur, një skenar të rremë, për të shpëtuar nga personat që Lato i kishte borxha në shuma marramendëse.

KUSH ËSHTË FESTIM LATO?

I vetëshpallur si 'President i Republikës së Çamërisë' ai lindi në Vlorë në vitin 1976, ndërsa jetonte në Holandë. Ai e fitoi shtetësinë holandeze, pasi u martua me një turke me shtetësi holandeze. Lato ishte vetëshpallur si 'President i Republikës së Çamërisë', ndërsa në Shqipëri ka një histori të gjatë me drejtësinë. Në SHqipëri ishte shpallur 'non grata' dhe ish-kryeministri Sali Beriaha ja kishte ndaluar të vinte në Shqipëri. Ai është dënuar disa herë për mashtrim, pas denoncimeve nga shumë persona. Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë ai është denoncuar dhe akuzuar për mashtrim me mijëra euro, që u merrte qytetarëve të ndryshëm me justifikimin për kauzën e Çamërisë. Në profilin e tij në faqen e Facebook-ut ai ka publikuar disa foto nga aktivitetet që sipas tij realizonte në Bruksel dhe vende të tjera për kauzën çame. Kundër tij nuk kanë munguar demaskimet për mbledhjen e fondeve përmes mashtrimeve, por që nuk kanë asgjë serioze për çështjen e shqiptarëve të Çamërisë.

Ja pyetjet që ju bënë Bashës nga prokurorët belgë

Katër përfaqësuesit e drejtësisë belge marrin në pyetje kryetarin e PD-së për dekonspirimin e aksionit të kapjes së 3.4 mln euro

ELTON QYNO
TIRANE

Katër prokurorë të mbëritur nga Belgjika kanë filluar marrjen në pyetje të kryedemokratit Lulzim Basha në ambjentet e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Gjatë intervistimit të Bashës janë duke asistuar dhe dy prokurorë Shqiptarë Ened Nakuçi dhe Doloreza Musabelliu,të cilët po kryejnë hetime në Shqipëri. “Shqiptarja.com” ndër pyetjet ju bënë kreut të PD janë:

1.Si u informua Lulzim Basha për sasinë prej 3,4 milionë Euro në makinën tip Toyota Yaris?

2.Cilat ishin informacionet ekzakte dhe kush ishte burimi I këtij informacioni?

3.Kush ia dha zotit Basha këtë informacion?

4.A ka lidhje shoqërore apo farefisnore Lulzim Basha me personat Alfred Vladi, Elvis Vladi, Edi Lika, Agim Ceka, Alban Mollaymeri, Niman Nimani, Alman Nimani, Albana Vladi, Arianit Nimani, Drita Sopo dhe Driton Hakaj.

5.A ka qënë ndonjë nga këto persona sponsorë të Partisë Demokratike apo zyrtarë shtetërorë gjatë kohës kur PD, drejtonte qeverinë?

Kujtojmë që personat që po verifikohen në Belgjikë janë Alfred Vladi, Elvis Vladi, Edi Lika, Agim Ceka, Alban Mollaymeri, Niman Nimani, Alman Nimani, Albana Vladi, Arianit Nimani, Drita Sopo dhe Driton Hakaj. Belgët janë vënë në dijeni në rrugë informale, se i pari që ka dhënë informacion për këtë çështje në sallën e parlamentit Shqiptar, ka qenë deputeti dhe kryetari i PD Lulzim Basha. Nisur nga kjo situatë prokurorët Belgë, kanë kërkuar nëpërmjet një letërporosie që prokuroria dhe policia shqiptare të marrin në pyetje Lulzim Bashën. Por nga fillimi i qershorit, e deri më tani, Belgët ndryshuan plan, duke zgjedhur të mos ja lenë hetimin e tyre palës Shqiptare, por të udhëtojnë vetë në Shqipëri, për të marë në pyetje Lulzim Bashën. 3.4 milion eurot u gjetën dhe u sekuestruan në makinën “Toyota Yaris” para disa muajve në Portin e Durrësit çështje, për të cilën, Lulzim Basha ka akuzuar një ditë para se ngarkesa të kapej, kreun e Grupit të Partisë Socialiste Taulant Balla, si të përfshirë në këtë çështje, ndërsa ky i fundit i ka cilësuar akuzat në emër të tij shpifje. Ndërkohë pak muaj më parë Belgët sollën në Shqipëri disa informacione përfshirë këtu dhe dëshmitë e disa personave, që janë shtetas belgë. Përgjigjia që ka mbërritur nga Belgjika në prokurorinë Shqiptare, për çështjen e 3.4 milion eurove të bllokuara në portin e Durrësit, duket se nuk ndihmon shumë hetimet e akuzës. Kjo pasi nuk jep të dhëna për origjinën e parave por dhe për personin që ka futur në “Toyota Yaris“ shumën e 3.4 milion eurove. Shitësi i kësaj makine është identifikuar në Belgjikë dhe është marrë në pyetje nga autoritet e këtij vendi. Gjatë marrjes në pyetje shtetasi Belg ka pohuar se nuk e njihte më parë personin që ia ka shitur makinën, pasi fillimisht kontakti me klientit është bërë nëpërmjet internetit dhe më pas është rënë dakord që të takoheshin nga afër për të parë dhe automjetin. Gjithmonë sipas dëshmisë së shtetasit belg, është takuar me klientin dhe më pas ka rënë dakord ti shiste automjetin shqiptarit. Për këtë çështje dy prokurorë shqiptarë, kanë shkuar në muajin dhjetor 2018 në Belgjikë duke marrë kontakt me palën belge dhe kanë kërkuar informacion mbi lëvizjet e dy kushërinjëve Alfred dhe Elvis Vladi. Hetuesit kanë marrë të dhëna edhe për sa i përket aktivitet kriminal të Alfred dhe Elvis Vladit në Blegjikë, ku sipas përgjigjes nga policia e këtij vendi thuhet se ata nuk janë proceduar ndonjëherë në Blegjikë për asnjë vepër penale. Por ndryshe nga sa thonë autoritet belge, njëri nga kushërinjtë Vladi, Elvisi tre vite më parë është arrestuar në Londër për përfshirje në një grup kriminal i specializuar në trafikun e kokainës. Emri i Elvis Vladit është pjesë e një dosje gjyqësore për një grup të organizuar kriminal shqiptarësh të përfshirë të tregtinë e kokainës. Ky grup kriminal në vitin 2016 do të dënohej me një total dënimesh prej 50 vite burg. Nga ana tjetër prokurorët kanë dyshime të forta se makina “Toyota Yaris“ është blerë nga Alfred Vladi dhe më pas në dyert e makinës është fshehur sasia e parave prej 3.4 milion euro, duke u nisur me pas në Shqipëri së bashku me 7 automjete të tjera që ishin ngarkuar në një kamion tip “Bizar”. I pari që nxori emrin e Alfred Vladit në prokurori ishte Alban Mollaymeri. I pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime Alban Mollaymeri deklaron se ka një aktivitet privat servis për makina. Ai deklaron se disa muaj më parë ka porositur disa makina të tipit “Toyota”, nëpërmjet njeriut të tij që quhet Alfred Vladi nga Tirana. Këto makina ai së bashku me Alfredin ai i gjente në internet dhe Alfredi i porositi jashtë Shqipërisë. Këto makina që kishin porositur kanë ardhur dhe ai ka shkuar në Durrës, për të bërë zhdoganimin e tyre. Nga kqyrja e telefonave të këtij personi ka rezultuar se Mollaymeri ka komunikuar me Alfred Vladin, menjëherë sapo është vendosur bllokimi i automjeteve. Ndërkohë që Mollaymeri, në këtë rast ka pohuar se nuk ka qenë ai porositësi i makinave por Alfred Vladi. Por nga verifikimi i dokumentacionit, “Toyota Yaris” ekziston se është porositur nga Mollaymeri.

TË HETURARIT

Kujtojmë që personat që po verifikohen në Belgjikë janë Alfred Vladi, Elvis Vladi, Edi Lika, Agim Ceka, Alban Mollaymeri, Niman Nimani, Alman Nimani, Albana Vladi, Arianit Nimani, Drita Sopo dhe Driton Hakaj.

Vrasja e Altin Balliut, dosja Olger Mustafa, shkon në gjykatë

Zbardhet dinamika dhe faktet e vrasjes që tronditi Korçën pas Vitit të Ri 2019

Viktima Altin Balliu

Elton Qyno
TIRANE

Olger Mustafa, person që konsiderohet me rrezikshmëri shoqërore në qytetin e Korçës dhe i akuzuar disa herë nga prokuroria e këtij qyteti, për disa vepra të rënda penale, është marë i pandehur dhe dërguar në gjykim për akuzën e "Vrasjes me dashje" dhe "Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake". Çështja penale kundër 33-vjeçarit Mustafa tashmë ka mbëritur në gjykatën e Korçës, ku pritet që në datën 30 korrik gjyqtarja Flojera Davidhi, të zhvillojë seancën e parë paraprake ndaj këtij të pandehuri. Mustafa, në 17 janar 2019 ka vrarë me katër plumba, dy në kokë, një në gjoks dhe një në kofshë, të riun Altin Balliu nga fshati Slabinjë e Pogradecit. Ngjarja që tronditi Korçën vetëm pak ditë pas Vitit të Ri, ka ndodhur për shkak të një zënke për bllokimin e rrugës, ku autori i krimit ka filluar të konfliktohet me viktimën Altin Balliu dhe shokët e tij që ndodheshin në makinë. Nga veprimet hetimore dhe analizimi me shumë vëmëndje të pamjeve filmike të një kamere që ka filmuar thuajse të gjithë konfliktin, del qartë se konflikti është provokuar nga autori i krimit Olger Mustafa, pasi ka dalë nga makina e tij dhe ka qëlluar me grushta në drejtim njërit prej shokëve të viktimës, që ndodhej në sediljen e parë të pasagjertit. Mandej kanë dalë dhe personat e tjerë që ishin në makinë dhe kanë ndjekur dhe sulmuar Olger Musatafën.Vetë viktima ka qënë në sediljen e pasme, duke qëndruar në mes, pasi kujtojmë që në makinë ndodheshin pesë persona. Olger Mustafa kishte vetëm disa kohë që ishte liruar nga gjykata e Korçës, pasi në shkallën e parë, Mustafa ishte dënuar në nënëtor 2010 me 12 vite burgim për "Vrasjen me paramendim" të mbetur në tentative në dëm të qytetarit Marko Hysolli. Pas daljes nga qelia, sërisht Mustafa përfshihet në një konflikt të dytë, ku për motive të dobëta ka vrarë me armë zjarri të riun nga Pogradeci, Altin Balliu. "Shqiptarja.com" zotëron dosjen e prokurorisë së Korçës ku jepet një tablo e qartë mbi dinamikën e këtij krimi të

Autori Olger Mustafa

rëndë. Ngjarja ka tre momente konfliktuale, ku i fundit është moment i vrasjes së Balliut nga Olger Mustafa. Hetimi i kësaj vrasje është ndjekur për 6 muaj me rradhë nga prokurori i çështjes Edmond Shytko. Pikërisht prokurori Shytko, relaton në vendimin përfundimtar të hetimeve ndaj Olger Mustafës se në datën 17 janar 2019 viktima Ilir Balliu ka qënë nën shoqërinë e shokëve të tij Julian Skoti, Julian Dragoti, Saimir Spaho, Guxim tar Dauti nga Struga, Rigels Sinani, Armand Sulollari, Ilirjan Fero. Të gjithë këta persona së bashki Ilir Balliun, para se të ndodhte krimi i rëndë, janë ulur në një lokal në lagjen nr.10 të qytetit Korçë. Pas rreth dy orë qëndrim në këtë lokal Altin Balliu dhe shokët e tij janë larguar duke u shpërndarë në dy automjete. Në ikje e sipër, makina ku ndodhej dhe viktima kishte zënë rrugën,ku për shkak të sasisë së akullit në rrugë, mjeti po bënte lëvizje të ngadalta për të hapur rrugën. I gjithë ky moment por edhe momenti i vrasjes është filmuar nga një kamera e instaluar në një biznes aty pranë.Në këto kohë vjen në kahun e kundër me mjetin që kishte zënë rrugën, Olger Mustafa, i cili me mjetin me targë AA296UB bënte me drita drejtuesit të makinës ku ndodhej viktima, që ti hapte rrugën për të kaluar. Por mjeti bënte lëvizje të ndadalta, kjo për shkak edhe të sasisë së akullit në rrugë.Por ngadalësia e tyre nuk i ka pëlqyr Olger Mustafës, i cili ka zbritur nga makina e tij dhe ka shkuar drejt makinës ku qëndronte Balliu me shokët e tij. E gjithë skena është filmuar nga kemara. Mustafa fillon të konfliktohet dhe në debat e sipër godet me grushta pasagjerin e parë që ndodhej në makinë, shokun e viktimës Altin Balliu, i cili ndodhej në sediljen e pasme. Pas kësaj Mustafa largohet por ndiqet nga pesë djetmë që ndodheshin në makinë të cilët e arrijnë dhe e qëllijnë me grushta. Mirëpo Mustafa ka mundur të hipë në makinën tip "Ëolsvagen" me të cilën udhëtonte dhe të largohet, ku në ikje e sipër ka dëmtuar dhe makinën e Guximtar Dautit që kishte zënë rrugën. Pikërisht në këtë moment njëri nga shokët e Altin Balliut ka njoftuar policinë e Korçës, për atë që kishte ndodhur dhe dëmtimin e makinës, dhe ishin në pritje të mbëritjes së policisë në vendgjarje. Ky sher ka ndodhur rreth orës 22:07 të natës, ndërkohë pas largimit, Mustafa pas 5 minutash kthehet sërisht në vengjarje. Sipas prokurorisë së Korçës Olger Mustafa këtë herë kishte marë një levë dhe ka filluar të konfliktohet me një person që qëndronte në këmbë dhe që mbante të veshur një xhup të kuq, i cili ishte Altin Balliu. Pamjet filmike tregojnë se mes tyre ka pasur një përleshje fizike, ku të dy kanë mbetur të dëmtuar, pasi Balliu është qëlluar me levë në kokë. Sërisht Olger Mustafa është larguar përsëri nga vendgjarja, dhe ka ikur me vrap. Por pas katër minuta më vonë, pikërisht në orën 22:15:53 sekonda sipas rregjistrimit filmik, Mustafa rikthehet ku këtë rradhë në dorë mbante një armë zjari pistoletë.Sapo kanë parë Mustafën me armë, personat që ndodheshin në vendgjarje janë shpërndarë duke u larguar me vrap. Mustafa ka filluar të qëllojë me armë në drejtim tyre, por një plumb ka prekur në kofshë Altin Balliun, i cili është rrëzuar në tokë. Mustafa e ka ndjekur Balliun, i është afruar dhe e ka qëlluar me pistoletë nga shumë afër, thuajse me puthitje, njëherë në gjoks dhe dy herë në kokë, duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme të riut Altin Balliu. Sipas prokurorisë së Korçës në momentin e vrasjes së Altin Balliu nga Olger Mustafa, nuk ka pasur njeri, veç qytetarit Saimir Spaho, i cili ka shkuar tek viktima dhe ka filluar të bërtasë "... e vrau, e vrau djalin...". Mustafa është larguar nga vendi i krimit duke mos u arrestuar në kohë nga policia. Për dy muaj ai ka qëndruar i fshehur, por në datën 7 mars 2019 është vetëdorëzuar në policinë e Korçës, duke pranuar autorësinë e krimit.

MUSTAFA U DËNUA NË 2010 ME 12 VJET BURGIM

Kush është Olger Mustafa e ngatëresa me Marko Hysollin për 1 mijë euro

Olger Mustafa, njihet si person me precdentë penalë në Korçë, i përfshirë në një tentativë vrasje, në aksidente rrugore, armëmbajtje pa lejë dhe tregtim lëndësh narkotike. Në vitin 2010 ai është dënuar me 12 vite burgim nga Gjykata e Korçës, ndërkohë gjatë pretencës prokurori i çështjes kishte kërkuar 18 vite burgim, por për shkak gjykimit të shkurtuar Mustafa përfitoi uljen e dënimit në masën e 1/3 duke u dënuar me 12 vjet. Gjatë procesit gjyqësor ai ka kërkuar falje dhe është shfaqur i penduar para gjykatës, për tentativën e vrasjes që kishte bërë ndaj shokut të tij në Korçë Marko Hysolli. Gjatë hetimit të kësaj dosje ka rezultuar se

Hysolli para 8 muajsh i ka dhënë shumën prej 1 000 euro borxh Olger Mustafa dhe ky i fundit nuk ia ka kthyer. Para një muaji në kohë, para se të ndodhte tentative e vrasjes Olger Mustafa në lagjen nr.6, të qytetit të Korçës,është goditur e rahur nga Marko Hysolli për moskthim të borxhit të dhënë. Sipas dinamikës së ndërtuar nga prokurori Gentian Stoja në 15 prill 2010 rreth orës 13:45 në Bulevardin "Shën Gjergji" të qytetit të Korçës,në afërsi të vendit të quajtur "ish-Bonboneria" Olger Mustafa ka qëlluar për të vrarë me armë zjarri automatik shokun e tij Marko Hysolli,i cili në momentin e ngjarrjes ka qënë duke drejtuar automjetin e tij tip "Audi" me targa AT 585 PT me drejtim lëvizje nga Turizmi për tek "Katedralja". Në makinë ishte i ulur në sediljen e parë Shahin Çela. Në momentin që Marko Hysolli po ecte përballë një banke të nivelit të dytë, nga trotuari i "Ish-Mapos" në anën e majtë të shoferit ka dalë Olger Mustafa dhe ka qëlluar me breshëri drejt Marko Hysollit dhe mjetit i cili ka ecur disa metra dhe ka qëndruar nga dëmtimet e marra në motor. Mbasi ka qëlluar me breshëri Olger Mustafa është larguar me vrap duke ecur në brendësi të lagjes 12 të qytetit të Korçës dhe në banesën e pabanuar të Josif Bendo ka hedhur armën e zjarrit automatik model 56, me qytë të prerë, me krëhër me 4 fishekë, me një fishek në folenë e armës.

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbarimore "616/A" shpall për shitje në ankand pasuritë e paluajtshme

1) Tokë Arë të debitorit Alketa Dema me sipërfaqe 2840 m2, me nr. pasurie 26/2-3, vol.18, faqe nr.233, zk. 2105, e ndodhur në Kashar, Tiranë. Pasuria shpallet për shitje me Vlerë fillestare ***1.017.856 lekë (Njëmiljon e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.***

2)Tokë Arë të debitorit Bedri Dema me sipërfaqe 2432 m2, me nr. pasurie 109/2, vol.6, faqe nr.6, zk. 2105, e ndodhur në Kashar, Tiranë. Pasuria shpallet për shitje me Vlerë fillestare ***4.835.205 (katërmiljon e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind pesë) lekë***.

Ankandi zhvillohet ditën e premte në datë 16.08.2019

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagjja Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë ; Cel:0682223020, e-mail: shoqeria616a@gmail.com

Borxhi publik në fund të 6-mujorit sa 63.03% e PBB-së

Në tre muajt e fundit detyrimi i shtetit është ulur 1 milion euro çdo ditë

Ritmi

Po të llogaritet mesatarisht, del që në tre muajt e fundit borxhi publik është pakësuar me 1 milion euro në ditë. Raporti ndaj PBB-së tanimë është më i ulët se ai në vitin 2013 (65.53%), kur PS mori pushtetin, por megjithatë mbetet mbi tavanin e dikurshëm të 60-përqindëshit

GENC KONDI
TIRANE

Borxhi publik vijon të ulet. Statistikat zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë bënë të ditur se, në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, shifra e përgjithshme e detyrimeve të shtetit brenda e jashtë vendit ishte 1 trilion e 105 miliardë lekë. Kjo shifër është pak më e ulët se ajo e shënuar në fund të vitit të kaluar (1.107 miliardë), por vihet re se tre muajt e parë borxhi ka vijuar të rritet, duke kaluar në 1.116 miliardë, ndërkohë që trendi ka ndryshuar tërësisht në tremujorin e dytë të vitit 2019.

Një paradoks vihet re në shprehjen e borxhit në euro, që rezulton më i lartë për tremujorin e dytë, krahasuar me të parin, në një kohë që shifrat në lekë janë në ulje. Kjo vjen nga fakti i forcimit të vlerës së lekut në tregun valutor. Kështu, Ministria e ka llogaritur me 125 lekë një euro në fund të marsit, ndërkohë që ky raport ka shkuar në 122 lekë për një euro në fund të qershorit. Rezultati: borxhi është 9 miliardë euro në fund të qershorit, ndërkohë që ishte 8 miliardë e 972 milionë euro në fund të dhjetorit 2018 dhe 8 miliardë e 904 milionë euro në fund të marsit 2019.

RAPORTET

Pas arritjes së një rekordi negativ të një borxhi publik të barabartë me 72.67 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vendit në fund të vitit 2015, tanimë shifra e detyrimeve ka arritur në 63.03 për qind të PBB-së. Kjo shënon një ulje të mëtejshme nga tremujori i parë, kur llogaritej në nivelin 63.63%. Me këto ritme, duket se nuk do të jetë e largët dita kur raporti borxh publik/PBB do të kthehet nën nivelin e 60 përqindëve, siç ishte deri në fund të vitit 2011. Kujtojmë se, deri atëhere, Kuvendi i Shqipërisë kishte vendosur me ligj organik të Buxhetit të Shtetit, që borxhi publik të mos kalonte nivelin e 60 përqindëve ndaj PBB-së. Kjo përputhej, në fakt, me të gjitha vlerësimet e ekspertëve vendas e ndërkombëtarë, të cilët vlerësojnë se rreziqet financiare për një ekonomi të vogël, siç është ajo e Shqipërisë, rriten tej mase dhe mund të bëhen të pakontrollueshme në rast se kalohet ky nivel. Por qeveria Berisha ndërmori një nismë në vitet e fundit të saj për të hequr krejtësisht tavanin referencë për rritjen e borxhit dhe aktualisht ende ky veprim nuk është korrigjuar nga mazhoranca e majtë. Berisha ishte informuar nga ministria e tij e Financave se, me borxhet masive, që kishte marrë qeveria për të ndërtuar Rrugën e Kombit dhe disa vepra të tjera insfrastrukturore, detyrimet publike do të rriteshin me ritme shumë të shpejta dhe kështu qeveria do të shkelte ligjin organik të Buxhetit. Kjo ndodhi me të vërtetë që nga viti 2012 e në vazhdim, por ndërkohë tavani nuk ishte më në fuqi.

ANGAZHIMI

Ulja e borxhit publik ka qenë një nga zotimet e hershme të qeverisë Rama, por vitet e para ky zotim nuk është mundur të mbahet, edhe për shkak të detyrimeve të prapambetura ndaj privatëve, për të shlyer të cilët qeveria u detyrua t'i shtrinte dorën Fondit Monetar Ndërkombëtar për një kredi të re 330 milionë euroshe. Por nga viti 2016 e këtej, si rezultat i rritjes së të ardhurave buxhetore, uljes së shpenzimeve publike dhe për pasojë deficitit shumë të ulët buxhetor, është arritur që shifra e borxhit më në fund të ulet.

Po të llogaritet mesatarisht, del që në tre muajt e fundit borxhi publik është pakësuar me 1 milion euro në ditë. Raporti ndaj PBB-së tanimë është më i ulët se ai në vitin 2013 (65.53%), kur PS mori pushtetin, por megjithatë mbetet mbi tavanin e dikurshëm të 60-përqindëshit.

DOKUMENTAT

Patentat dhe lejet ndërkombëtare tani edhe tek zyrat qendrore të DRSHTRR

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) njofton të gjithë ata që duan të udhëtojnë jashtë shtetit se leja e drejtimit ndërkombëtar dhe leja e qarkullimit ndërkombëtar, mund të tërhiqen edhe te zyrat e DRSHTRR Tiranë, pranë Qendrës së Kolaudimit të Mjeteve (ish-NSHRAK-u), përveçse në DRSHTRR Tiranë në Kashar.

"Shërbimi i ri i ofruar edhe në Tiranë, shmang radhët dhe kursen kohën në këto ditë të nxehta. Të interesuarit për të marrë dokumentet e lartpërmendur, duhet të kenë me vete: leje drejtimi kombëtare/leje qarkullimi kombëtar, dokument identifikimi, 1 fotografi për leje drejtimi ndërkombëtare", thuhet në një njoftim të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Leja e drejtimit ndërkombëtare dhe leja e qarkullimit ndërkombëtare janë të vlefshme për 3 vite me tarifën 500 lekë.

BANKAT

20 kompanive më të mëdha debitore u mundësohet ristrukturim kredie

20 kompani të mëdha në vend, që mbajnë peshën kryesore të kredive me probleme, do të kenë mundësi ristrukturimi të huave që kanë marrë. Banka e Shqipërisë ka miratuar një rregullore të re, që njihet me emrin "Qasja e Tiranës". Ajo parashikon që bizneset që kanë marrë kredi në më shumë se një banke me vlerë mbi 250 milionë lekë, do të kenë mundësi të rinegociojnë me bankat përkatëse të mbështetur edhe nga ajo qendrore, me qëllim tejkalimin e situatës së vështirë financiare dhe shmangien nga falimentimi.

"Ideja është që një kreditor i ekspozuar në më shumë se një bankë që ka marrë një shumë të konsiderueshme hua, të mos shkojë direkt në falimentim apo të konsiderohet një kredimarrës plotësisht i keq, por nëpërmjet bashkëpunimit me bankat të shikohet mundësi e ringritjes, të ndihmohet në të gjitha mënyrat e mundshme që të vijojë biznesin, por duke i ofruar lehtësira si zgjatjen e afatit të kredisë, ndonjë mundësi rifinacimi qoftë në kapital. Pra kemi të bëjmë me një ndihmesë mes kredimarrësit dhe huadhënësit që ndodhet në vështirësi financiare", tha Spiro Brumbulli, sekretar i shoqatës së bankave.

Deri më tani nuk kishte një rregullim ligjor për kreditorët e këqij që rezultojnë me më shumë se një kredi. Dokumenti i ri synon që të ulë më tej huatë me probleme të cilat aktualisht janë në nivelin e 11%.

Shoqata e Bankave pritet të konkretizojë edhe nismën për krijimin e byrosë së kredisë. Kjo byro, në ndryshim nga regjistri i kredisë që administron Banka Qendrore, parashikohet të mbledhë informacion jo vetëm për ekspozimin e huamarrësve në banka, por edhe ndaj institucioneve të tjera si OSHEE, ujësjellës kanalizime etj me qëllim për të vlerësuar historikun e tyre të pagesës para se të aplikojnë për një kredi.

VENDIMI I QEVERISË

Ja sa do të jetë qiraja për qytetarët e strehuar në banesa sociale

Si llogariten kostot për shtëpitë e reja dhe ato jashtë funksionit

Në mbledhjen e djeshmë të Këshillit të Ministrave është miratuar një medotikë e re për llogaritjen e qirasë të banesave sociale. Me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave, ka përcaktuar mënyrën e llogaritjes së qirasë së banesave sociale, që financohen nga buxheti i shtetit dhe/ose i njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipas VKM-së, masa e qirasë për banesat sociale, që sigurohen me financime të sektorit privat, përcaktohet nga subjektet që e kanë financuar, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore, dhe nuk është subjekt i këtij vendimi. Mënyra e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale, e përcaktuar me këtë vendim, u referohet banesave sociale me qira, që sigurohen nëpërmjet ndërtimit të banesave të reja; banesave sociale që blihen në treg dhe objekteve të dala jashtë funksionit, të transformuara në banesa sociale. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, llogaritet në varësi të kostos së ndërtimit ose të vlerës së blerjes së banesës në treg. Masa vjetore e qirasë nuk mund të jetë më e madhe se 3% e kostos së ndërtimit ose e vlerës së banesës së blerë në treg.

Vlerësimi
Për llogaritjen e masës së qirasë për banesat sociale që sigurohen nëpërmjet ndërtimeve të reja, në koston e ndërtimit përfshihen të gjitha shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit të banimit

Fuqia
VKM shfuqizon atë të 24.2.2010 "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale financohen nga buxheti i shtetit e buxheti i bashkive" e hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare

VLERAT

Për llogaritjen e masës së qirasë për banesat sociale që sigurohen nëpërmjet ndërtimeve të reja, në koston e ndërtimit përfshihen të gjitha shpenzimet e kryera për ndërtimin e objektit të banimit, të tilla si vlera e investimit për ndërtimin e ndërtesës; vlera e plotë e projektit teknik; kostoja e blerjes së tokës, kur ajo nuk është pronë e njësisë së vetëqeverisjes vendore; vlera e investimit për lirimin e sheshit të ndërtimit; vlera e mbikëqyrjes së punimeve; taksat, tatimet dhe tarifat e aplikueshme gjatë ndërtimit të objektit; kostot e menaxhimit të zbatimit të projektit; kostot për kolaudimin dhe ato për tarifën e regjistrimit të pronës në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK).

PËRJASHTIMET

Në koston e ndërtimit nuk përfshihen vlera e truallit, kur investimi është bërë në truall, pronë e njësisë së vetëqeverisjes vendore; investimet për lidhjen me rrjetin kryesor të infrastrukturës, si ujësjellës, kanalizime, telefoni, energji elektrike; vlera e investimit për katet e para, kur këto nuk janë të parashikuara për banesa sociale; taksat, tatimet dhe tarifat vendore, të cilat, për projektin në fjalë mund të jenë konsideruar si kontribut i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

OBJEKTE JASHTË FUNKSIONI

Për objekte të dala jashtë funksionit, të përshtatura në banesa sociale, masa e qirasë llogaritet mbi vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre. Në këtë vlerë përfshihen: vlera kapitale e transferuar e objektit (siç pasqyrohet në regjistrin e kontabilitetit), duke llogaritur edhe shkallën e amortizimit për shkak të përdorimit normal dhe të zakonshëm të tij; kostoja e ndërhyrjes/investimit për përshtatjen e tyre në banesë sociale; tarifa për regjistrimin e pasurisë; çdo shpenzim tjetër, i kryer me financime të buxhetit të shtetit ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

LLOGARITJA

Për llogaritjen e masës së qirasë mujore për çdo apartament veprohet, si më poshtë vijon. Fillimisht llogaritet qiraja e përgjithshme vjetore për të gjithë objektin, duke shumëzuar me 3% koston totale që ka dalë nga llogaritjet e para. Më pas llogaritet përqindja që zë sipërfaqja e çdo apartamenti ndaj sipërfaqes totale të ndërtimit. Përqindja, që rezulton nga ky veprim, shumëzohet me vlerën e përgjithshme vjetore të qirasë, siç u llogarit më sipër. Vlera, që rezulton nga veprimi, pjesëtohet me numrin 12.

BANESAT E BLERA

Për banesat sociale që blihen në treg, masa e qirasë llogaritet në bazë të vlerës së blerjes së banesës në treg. Në këtë vlerë përfshihen vlera e investimit për blerjen e banesës; shpenzimet për riparime; kostoja për regjistrimin e pronës; taksat dhe tarifat e aplikueshme; çdo shpenzim tjetër i paparashikuar.

Në rastin kur në katet e para të objektit të ndërtuar janë parashikuar mjedise shërbimi, qiraja e tyre, në varësi të destinacionit, mund të përcaktohet sipas nivelit të qirave të objekteve të ngjashme në treg.

Për çdo objekt të ri që ndërtohet, adaptohet ose blihet në treg, masa e qirasë llogaritet vetëm një herë dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ky nivel qiraje përdoret deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës. Çdo vit, niveli i qirasë së miratuar nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shumëzohet me indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim shfuqizon atë të datës 24.2.2010, të Këshillit të Ministrave "Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i bashkive apo nga kombinimi i të dyjave" dhe hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

PRONAT NË BREGDET

Monitorimi i pasurive të patundshme nga Task Forca deri 31 dhjetor

Këshilli i Ministrave ka vendosur dje shtyrjen e afatit të monitorimit të zonave bregdetare nga Task-Forca. Afati i ndryshuar ka qenë deri në datën 31 korrik 2019 dhe është shtyrë deri në datën 31 dhjetor 2019.

Task-Forca monitoron, mbikëqyr dhe ndjek në kohë reale të gjitha ndryshimet, përditësimet, regjistrimet si dhe çdo veprim tjetër të kryer nga organet shtetërore në lidhje më pasuritë e paluajtshme shtetërore, të cilat ndodhen brenda fashës 1.5 km nga vija bregdetare. Institucionet dhe organet shtetërore vënë në dijeni Task-Forcën në lidhje me të gjitha zhvillimet dhe ndryshimet që do të ndodhin në statusin juridik të pasurive të paluajtshme shtetërore përgjatë vijës bregdetare.

Ky vendim ka hyrë menjëherë në fuqi menjëherë.

INFORMALITETI

Tregu informal i taksive, bllokohet hetimi i Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës nisi pak muaj më parë një hetim në tregun e taksive për shkak të ankesave ndaj disa operatorëve në treg. Por duket se avancimi i hetimit ka qenë i pamundur në kushtet kur një pjesë e mirë e institucioneve që duhet të kishin dërguar informacion pranë këtij autoriteti e kanë bërë atë me vonesë ose ende pritet që të mblidhet. Në një vendim të pak ditëve më parë, AK bëri me dije se raporti pritet të dalë jo më vonë se data 14 tetor 2019.

Në prill të këtij viti Autoriteti bëri me dije se tregu i taksive është vendosur nën hetim nga për shkak të ankesave që në drejtim të operatorëve në kryeqytet. Ankesat kanë të bëjnë me caktimin e çmimeve dhe tarifat në shërbimin e transportit të udhëtarëve me taksi në Tiranë. Hetimi paraprak përfshin periudhën nga 1 janari 2018 deri në 31 mars 2019. Në objekt të hetimit do të jetë vlerësimi i tregut për të parë nëse ka apo jo shenja të kufizimit të konkurrencës. Në vëzhgimin e përgjithshëm të tregut Konkurrenca ka vlerësuar më herët se pavarësisht se ekziston një çmim tavan prej 250 lekësh për 1.5 kilometrat e parë si tarifë fillestare për shërbimin taksi kompanitë mund të kalibrojnë taksimetrin në vlera më të ulëta. Por rezulton që pothuajse të gjitha aplikojnë të njëjtën tarifë fillestare.

AKSIDENTI NE TIRANE

Shpërthen transformatori, vdes punonjësi, plagosen dhe 2 të tjerë

Ngjarja e rëndë në autostradë, solli një viktimë dhe dy persona të plagosur nga shpërthimi

Një shpërthim i fuqishëm në një transformator elektrik në një objekt në rikonstruksion mesditën e djeshme, i mori jetën një punëtori të firmës private të ndërtimit. Të plagosur mbetën edhe dy punonjës të tjerë të kompanisë së ndërtimit, të cilët janë në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, në repartin e djegieve. Shpërthimi ndodhi në një objekt në ndërtim në rrugën dytësore në autostradën Tiranë-Durrës, ndërsa të plagosur mbetën Gjergji Sula, Fari Çollaku rreth 50 vjeç, dhe Andi Bojni 22 vjeç. Por Sula ndërroi jetë në Spitalin e Traumës ndërsa dy të tjerët ndodhen në QSUT me djegie në të gjithë sipërfaqen e trupit.

SHKËNDIJA ELEKTRIKE

Policia thotë se transformatori shpërtheu si pasojë e një shkëndije elektrike, ndërsa në një reagim më të detajuar për ngjarjen, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sqaroi se: Një kompani private, ishte duke kryer punime në autostradë, ku dy punëtorë të kësaj firme kanë shkurtuar distancën me linjën 110 kV të OST, çka ka shkaktuar masë.Siç "Shqiptarja.com" mëson, duke qenë se i janë afruar shumë linjës, OSHEE ka ndërhyrë duke stakuar energjinë elektrike në nënstacionin e Kasharit, për të shmangur pasoja më tragjike nga shpërthimi i shkaktuar. Ky defekt la pa energji perrëth 15 minuta bizneset përgjatë autostradës, zona e Kamzës, Vora dhe Mëzez.

REAGIMI I OSHEE-SË

"Grupi i punës së avarisë së OSHEE mori masa për furnizimin menjëherë të nënstacionit me linjën rezervë dhe që prej ditës së djeshme kanë marrë energji të gjithë zonat e lartpërmendura. Kemi stakuar për masë vetëm fiderin që furnizon me energji zonën pranë subjektit në rikonstruksion"-thotë OSHEE në një njoftim për ngjarjen."Stafi mjekësor i QSUT ka qënë në gatishmëri të plotë për tu kujdesur për këta pacientë,duke zbatuar të gjitha protokollet mjekësore dhe duke i mbajtur në monitorim të vazhdueshëm në reanianimacionin e shërbimit të Djegie Plastikës"-thuhet në një njoftim të QSUT-së. Për ngjarjen reagoi edhe Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, ku teksa shpreh ngushëllime familjes së viktimës, i kërkon autoriteteve të zbardhin ngjarjen. KSSH kërkon të zbardhet nëse ka pasur mangësi për plotësimin e kushteve të sigurisë teknike. Nëse rezulton kështu - thotë Konfederata- atëherë përgjegjësit duhet të ndëshkohen sipas ligjit. "Mungesa e sigurisë teknike në punë shkakton tragjedinë e radhës. Autoritetet të tregojnë transparencë pasi ka indicie se po tentohet të fshihen përmasat e pasojave të ngjarjes", thuhet në reagim. Nga shpërthimi i transformatorit elektrik në një objekt në ndërtim në autostradën Tiranë-Durrës, ndërroi jetë një prej punëtorëve të firmës private të ndërtimit, dhe u plagosën rëndë edhe dy të tjerë.

Tiranë / Mashtrimet e biznesmenëve nga Violeta Petro, denoncime të reja

Shtohen denoncimet për mashtruesen, UNICEF: Nuk ishte punonjësja jonë

Shtohen denoncimet në polici për 64-vjeçaren Violeta Petro, e cila dy ditë më parë u prangos nga Policia e Tiranës, pasi akuzohet se ka mashtruar biznesmenë duke u premtuar projekte të mëdha ndërtimi të financuara nga një organizatë e huaj, UNICEF. Burime pranë policisë konfirmojnë për Report Tv se vetëm ditën e djeshme, në drejtorinë e policisë janë paraqitur edhe dy persona të tjerë, duke e kallëzuar atë për mashtrim. Mësohet se deri më tani, numri i denoncimeve për Petron ka



shkuar në 9, e ndërsa dëmi i shkaktuar arrin në vlerën e rreth 1 milionë eurove. Gruaja 64 vjeçare hiqej si pjesë e fondacionit të huaj, duke mashtruar biznesmenë se për t'u bërë pjesë e projekteve të tyre, kryesisht me çerdhe për fëmijë e azile të moshuarish, fillimisht duhet të paguanin nga 1% të vlerës që do të shkonte ndërtesa. Më herët, burime thanë për "Report Tv", se mes personave të mashtruar nga ana e 64 vjeçares, ishte edhe vëllai i Rebani Jaupit, drejtorit të Policisë së Tiranës. Pas zbulimit të kësaj skeme mashtrimi nga ana e 64-vjeçares, policia i kërkoi informacion edhe organizatës UNICEF, sipas së cilës në asnjë moment nuk ka pasur të regjistruar punonjëse të identifikuar me emrin Violeta Petro. Ndërkohë në dëshminë e saj, Petro ka mohuar të ketë mashtruar njeri, por duke mos i dhënë policisë asnjë argument bindës. 64-vjeçarja akuzohet për veprat penale "Mashtrimi", "Fshehja e të ardhurave" dhe "Mospagimi i taksave dhe tatimeve".

REAGON SHQIPTARI NGA MAQEDONIA

"Veç plumbi për ty", Rama kërcënohet në faqen e këshilltarit të Bashës!

Një person i veshur me veshje ushtarake i cili mban në profilin e tij të Facebook edhe foto ku shfaqet i armatosur ka bërë një koment kërcënues për kryeministrin Edi Rama në faqe e një prej këshilltarëve të kryedemokratit Lulzim Basha. Përveç fjalëve ofenduese, ai përdor edhe terma kërcënues. "...O të q... psikopatin e nanës, po a ngrihet dorë mbi popullin



tënd. O drog, o Krista, veç plumbi për ty"-shkruhet në komentin e faqes së këshilltarit të Lulzim Bashës. Për "Shqiptarja.com" ka reaguar Nuredin Asani i cili është shqiptar i Maqedonisë së Veriut, duke thënë se publikimi nuk është bërë nga ai, dhe se ka disa kohë që rrjetet sociale ja kanë vjedhur persona të panjohur për të. "Ka dy javë që më hakerojnë dhe e njëjta ka ndodhur edhe me publimin e djeshëm. Dua të njoftoj se dikush që më do të keqen më ka marrë passëordin dhe të njëjtin e keqpërdor për qëllime të fëlliqura. Nuk jam unë një person i tillë. Të njëjtin problem e kam paraqitur sot edhe në organet e rendit në vendin tim, Maqedoninë e Veriut", thuhet në reagimin e tij.

Ngjarja në Durrës

Qëlloi për vdekje një person dy vite më parë, kapet 46-vjeçari

Ilir Haku 46-vjeç nga qyteti i Durrësit ka rënë në prangat e policisë pasi akuzohet se në 7 shtator të 2017 qëlloi për vdekje me thikë Afrim Llanën në tregun industrial të Durrësit. Llana mbeti fillimisht i plagosur por vdiq pas 5 ditësh nga plagët e marra. Autori u arrestua fillimisht por u la i lirë pasi dyshohej se vdekja kishte ardhur nga një infarkt. Më pas ekspertiza vërtetoi se viktima humbi jetën për shkak të plagëve të marra nga thika. Gjykata e Durrësit e ka dënuar Hakun me 6 vjet e 8 muaj burgim, nga të cilat i kanë mbetur për të vuajtur edhe 4 vjet e 6 muaj e 13 ditë burgim për veprën penale "Plagosja e rëndë me dashje".

NJOFTIM

BSA
Bailiff Services Albania

Shoqëria Përmbarimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurat për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të z.Et'hem Xhelaj dhe znj.Zilo Xhelaj, lënë garanci për "OTP Bank" sh.a

-NË DATË 15.08.2019 ORA 16:00.

-"Ndertese" Pasuri nr. 54/49-ND, Vol.21, Fq.57, ZK.8605, me sip.20 m² me adrese lagja "28 Nentori", Vlore, ne pronesi te z.Et'hem Xhelaj dhe znj.Zilo Xhelaj, me çmimin fillestar 1,523,200 leke.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

“Bursa dhe tarifa të përgjysmuara edhe në vitin e ardhshëm akademik”

Ministrja e Arsimit Besa Shahini sqaron studentët gjatë ceremonisë së prezantimit të 223 të punësuarve

Paktin për Universitetin, s’ka më kthim prapa! Kështu u shpreh ministrja e Arsimit Besa Shahini, teksa shtoi se bursat dhe tarifat e përgjysmuara vazhdojnë edhe vitin e ardhshëm akademik. E pranishme në ceremoninë e prezantimit të 223 të punësuarve falë “Programit Kombëtar të Praktikave të Punës” Shahini në fjalën e saj përballë studentëve që në përfundim të praktikës u punësuan, nënvizoi vëmendjen e veçantë që MASR i kushton lehtësimit dhe mbështetjes në mënyrë të vazhdueshme për kalimin nga arsimi në tregun e punës. “Programi Kombëtar i Praktikave të Punës mishëron më së miri vlerat dhe arritjen e këtij objektivi. Sot që flasim, jemi në vitin e 4-t të këtij programi, një vit edhe më i konsoliduar në të gjitha aspektet. Sot nis edhe rrugëtimi i punësimi i 223 praktikantëve në institucione të ndryshme qendrore, vendore dhe kompani private. Në periudhën Mars-Qershor 2019 janë zhvilluar 951 praktika pune 3-mujore, prej të cilave u kemi hapur rrugën e punësimit njëvjeçar më të mirëve falë performancës së tyre të lartë që kanë treguar”, tha Shahini.

Duke u ndalur gjithashtu tek “Pakti për Universitetin”, Ministrja Shahini theksoi vëmendjen maksimale të qeverisë shqiptare ndaj studentëve dhe përmirësimit të arsimit të lartë. “Pakti për Universitetin është fillimi i punës tonë qe kemi nisur. Kemi vendosur të shtojmë buxhetin - jo vetëm për këtë vit, por edhe për vitet në vijim për të investuar në kampuset universitare apo çdo gjë tjetër që kanë nevojë studentët. Këtë vit, shtesa në buxhet kapi vlerën e mbi 2.3 miliard lekëve prej të cilës përfituan gati 90% e studentëve”, shtoi Ministrja Shahini.

Ministrja hodhi dritë edhe mbi lajmet që qarkulluan javën e fundit mbi ndërprerjen e dhënies së bursave dhe përgjysmimin të tarifave nga viti i ardhshëm akademik e që shkaktoi shqetësim në rrjetet sociale mes studentëve universitare. “Kemi ndërtuar një pako financiare për të përgjysmuar tarifat dhe për të stimuluar me bursa studentët më të mirë dhe kategoritë që kanë më shumë nevojë për ndihmë nga shteti. Kjo do vijojë të zbatohet edhe për vitin tjeter akademik përkundër disa lajmeve nëpër portale që përhapin panik duke thënë se nuk do vijohet më me përgjysmimin e tarifave dhe shpërndarjen e bursave. Kjo nuk është e vërtetë pasi politika që ndoqëm vitin e kaluar do vijojë në të njëjtën mënyrë edhe në vitin e ardhshëm akademik. Do të zbatohet edhe më mirë pasi kemi mësuar shumë gjatë procesit të zbatimit të politikës gjatë gjysmës se parë të këtij viti. Kemi patur probleme me segretaritë nëpër universitete për probleme banale që i hasim ndonjëherë dhe që shkaktonin vonesa por tashmë kemi mësuar se si të arrijmë deri tek studentet në kohën e duhur” sqaroi ministrja.

EDICIONI I II / INVA MULA: MË BUKUR NUK MUND TË FILLONTE

Korçë, “Mik Festival” nis për dy piktoret e para shqiptare

Mik Festival” është rikthyer në Korçë mbrëmjen e së mërkurës. Ideuar nga sopranoja Inva Mula ky festival për 5 netë radhazi do të sjellë në Korçë vlerat më të mira muzikore shqiptare e botërore. Nata e parë ishte dedikim kushtuar motrave Zengo, piktoreve të para femra shqiptare. Pas përfundimit të natës së parë Inva Mula u shpreh se kjo ishte një natë historike për artin shqiptar. “Mendoj se më bukur se kështu nuk mund të fillonte asnjë festival tjetër. Nesër ju ftoj në një natë të paharruar që do të jetë kushtuar Spanjës. Kemi koncert këtu në teatër me një trio të shkëlqyer të muzikës spanjolle dhe flamengon në skenën e madhe të pazarit të vjetër. Më pas do të vazhdojmë me natën vjeneze. Pastaj në ditët e shtunë kemi 15 këngëtarë të rinj që do më shoqërojnë në një natë të mbushur plot me emocione me orkestrën e akademisë së arteve ‘Ibrahim madhi’, me Suzana Turkun, me Genc turkiçin, me Dëshira Ahmetin, me Igli Tugën. Ka plot artistë të shkëlqyer të cilat do ndajnë me njëri tjetrin dhe do ta mbyllim me natën e serenatave, ditën e dielë”, u shpreh Inva Mula.

Dy personalitet e shquara të artit korçar Jani dhe Vangjush Papadhimtri interpretimin në këtë natë e cilësuan si detyrim në nder të nënës dhe tezes së tyre. “Ndjehem si në ëndërr akoma sepse e kishin ëndërruar një diçka të tillë. Bashkia e Korçës i ka nderuar me titullin ‘Qytetar Nderi’, të dyja motrat, Andronikin dhe Sofia Zengon. Një mbrëmje për ato dy gra që vunë themelet e pikturës, pra gratë e para piktore, të cilat janë korçare”, u shpreh Papadhimitri. “Kanë vërtetë vlerë të madhe dhe sa më të shpeshta të jenë do të jetë me bukur dotë jetë gjithmonë e në vazhdimësi. Luajtëm pjesë të ndryshme, nga Tango, Jazz, muzikë shqiptare dhe të gjitha rrymat shqiptare”, tha Viola Papadhimitri.

Mbështetja për këtë aktivitet është dhënë nga Banka Credins. “E nderuar që Zonja Inva mendon për të zhvilluar talentet e reja në Shqipëri. Shkolla Shqiptare gjithmonë ka prodhuar talente në fushën e artit. Ne si bankë ndihemi të lumtur që kemi mbështetur këtë iniciativë dhe jam e bindur që do vijomë ta mbështesim edhe në vitet në vijim, duke qenë të bindur në suksesin e jashtëzakonshëm që do ketë”, u shpreh përfaqësuesja e Bankës Credins. Mik Festival do të vazhdojë përgjatë këtyre netëve duke sjellë dimensione të reja ku shpirti i muzikës do të shpaloset me traditat vendase të kulinarisë.

VENDIMI I RI / FLET KRYETARJA E AGJENCISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT E MBROJTJES SË FËMIJËS

Alma Tandili: S’ka më fëmijët të pa pashoqëruar në qendra interneti

Propozimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për moslejimin e fëmijëve nën moshën 14-vjeç, të pashoqëruar në qendra interneti, tashmë janë miratuar me vendim qeverie. Ky vendim është marrë me qëllimin për të mbrojtur fëmijët nga informacioni që ata marrin, i cili mund të jetë i dëmshëm, si dhe për të mbrojtur privatësinë dhe identitetin e tyre.

Kryetarja e agjencisë shtetërore për të drejtat e mbrojtjes së fëmijës, Alma Tandili, shpjegoi se si do të procedohet në qendrat e internetit, për t’u njohur me moshën e fëmijës, pasi deri në moshën 16 vjeçare, nuk mund të pajisesh me kartë identiteti. “Teknikisht besoj që nga ana praktike, një fëmijë deri diku duket, është e dukshme kur hyn në një sallë interneti për moshën e tij, por sigurisht që ndoshta nuk është e qarte 14 e një ditë 14 e dy tre ditë, pra mosha ekzakte. Megjithatë do kërkohet fëmijët që shikohen, të miturit faktikisht, do kërkohet që shoqërohen”, u shpreh Alma Tandili

Nevoja për këtë vendim, lindi pasi po jetojmë në një mjedis dixhital, ku komunikimi virtual është shumë herë më i lartë se komunikimi i drejtpërdrejtë dhe se interneti ndikon në psikologjinë e fëmijës. Vendimi sapo ka hyrë në fuqi dhe së shpejti do të mblidhet dhe grupi i ekspertëve për të vendosur se si do të vijohet më tej, për kontrollimin e qendrave të internetit, për zbatueshmërinë e këtij vendimi. “Sapo ka dalë vendimi, ne jemi në konsultim dhe së shpejti do të mblidhemi te gjithë grupi i ekspertëve për të parë dhe për të vendosur sepse VKM-ja tashmë e ka parashikuar që është dhe AKEP dhe AKCES, që janë dy institucionet përgjegjëse të cilat kane ekspertizën përsa i përket përmbajtjeve të materialeve”-tha Alma Tandili

Deri në këto momente reagimet kanë qenë pozitive si nga ana e prindërve ashtu dhe nga qendrat e internetit, të cilët janë interesuar për të marrë më tepër informacione se si do të operohet në vazhdim.

D.Sallaku

ANALIZA

Tallashi dhe algat si diversion ndaj problemeve të vërteta

Eol ÇASHKU
TIRANE

Disa aktorë dhe thuajse asnjë dramaturg dhe regjisor teatri, kanë zgjedhur si platformë faktorizimi "betejën" për mbrojtjen e një ngrehine e cila nuk ka qënë kurrë teatër. As kur u ndërtua para 80 vjetësh. Gjithashtu grupe politikanësh me përgjegjësi totale politike, morale ndoshta edhe ligjore mbi gjëndjen rokopuje ku ndodhet sot sistemi ynë artistik, marrin guximin të shfrytëzojnë politikisht një ngrehinë të shpartalluar e të amortizuar në pikën e moskthimit, nga ata vetë.

Godina sot por dhe qëkurse u ndërtua si qendër argëtimi për ushtrinë (estradë ushtari) nuk përmbush asnjëlloj kushti për t'u quajtur a për të qënë një Teatër fshati e aq më pak një Teatër Kombëtar. Në 75 vjet, artistët dhe krijuesit e artit skenik u lanë të krijonin artin e tyre të madh në kushte tërësisht çnjerëzore. Ky i joni duhet të jetë i vetmi "teatër" nga Maroku në Azerbajxhan, i cili nuk ka dhe nuk ka pasur kurrë qëkurse u ndërtua, llozha aktorësh. I vetmi i cili nuk ka një garderobë dhe një rrobaqepsi të ndara nga njëra tjetra. Rrobaqepsia dhe graderoba janë një dhe për t'u veshur dhe zhveshur, aktorët duhet ta bëjnë këtë me rradhë. Sapo del nga rrobaqepësi/garderoba, diku në mes të korridorit të katit të dytë, ndodhet një tavolinë me pasqyrë me llampa gjysma prej të cilave të djegura. Mos u habisni, është "llozha" e grimit... Vazhdon pak më poshtë dhe zbret drejt shkallëve të amortizuara një po një jo, dhe hop, e gjen veten tek kavot e perdeve në kuinta tek dispaçi elektrik e dy metra më tutje, je në skenë. Skenografët shqiptarë nga më të mirët në rajon e pse jo në europë, historikisht kanë vuajtur e janë ankuar për pamundësinë e ndërtimit të thellësisë dydimensionale të skenografive të shfaqjeve që janë vënë në skenë, për faj të mungesës thuajse totale në gjatësi të fondalit të skenës. Marangozeria (ndërtimi i dekoreve) diku pas pishinës veç rrëmujës së paimagjinueshme është e reduktuar në minimumin strikt të hapësirave që nevojiten. Dhoma e aksesorëve po ashtu.

Gjatë një shfaqjeje, kur aktorëve u duhet të ndërrojnë krahun e hyrjes në skenë, u duhet të kalojnë në një tip tuneli poshtë skenës që qelb era lagështirë e urinë. Sistemi rotativ i skenës me gjasa manual i modifikuar, më mirë mos të përdoret se sado vaj e graso të ketë prap zhurmon pa limit decibelësh. Në banjot e "Teatrit Kombëtar" duhet të hysh me kurajo e kundragaz kur je publik i thjeshtë. Duhet të kesh kujdes kur lan duart në lavaman kur mbaron së kryeri nevojat, se mos të lagen këmbët ngaqë lavamani nuk ka sifon fare. Si aktor apo teknik, mund të lirohesh më mirë rrëzë mureve apo ndonjë peme jashtë gjatë entraktit, sesa në "banjën" e artistëve. Si spektator në dimër duhet të vish ose i pirë ose me një shishe raki për të përballuar të ftohtin e në verë nuk mund të shohësh shfaqje hiç nga i nxehti. Pasi ke mbaruar shfaqjen pastron grimin me një pambuk me ujë, e pas një kafeje me kolegë e dashamirës, djersën shkon dhe e heq me një dush të lumtur në shtëpi, pasi dushe "Teatri ynë Kombëtar" nuk ka dhe nuk ka patur. Ushtarët e 1939, pas argëtimit laheshin në dushet e kazermave të tyre. Godina e vetme(sot Kuvendii) që u projektua e u ndërtua për Teatër dhe e cila plotëson çdo kusht teknik, si gjërësinë dhe gjatësinë e fondalit(sot thellësia e fondalit përbën kafenenë e parlamentit) të skenës nuk shërbeu fatkeqësisht kurrë si e tillë. Gjatë diktaturës komuniste Teatri posedonte edhe të vetmen pishinë të Kryeqytetit deri në mes të viteve 80.

Sot nga ajo pishinë mbeten vetëm gojëdhënat sureale fëmijëve të artistëve(të vetmit që kishin të drejtë të laheshin në të) se si i madhi Roland Trebicka hidhej në pishinë me kokë dhe kur dilte kishte vetëm trupin të lagur dhe kokën të thatë. Të gjitha trupat e huaja që do të vijnë do u duhet të reduktojnë shkallën e ndërtimit të skenografive e të reduktojnë elementë dekori. Partia komuniste (por edhe disa prej forcave politike të sotme) kishte një raport më së paku të çuditshëm me objektet e alokuara për artin teatror. Kështu, salla e parlamentit të parë shqiptar në mënyrë semiotike tallëse u shëndrua në Teatër Kukullash. Salla e ndërtuar për teatër u bë parlament, dhe salla e argëtimit të ushtarëve fashistë u kthye në teatër. Sallat e kinemave u kthyen në bingo(dikur edhe salla e Teatrit Eksperimental të sotëm) dhe disko me emra nga më haluçinantët. Qendrat kulturore në bilardo. Kinostudio në telerepublikë. Absurdi semiotik nuk ndaloi deri në vitin 2013 kur SHQUP (Shtëpia Qendrore e Ushtrisë Popullore) së fundmi Ansambli dhe Qendra Multimedia e Ushtrisë, u shëndërua nga një aset kulturor të gjithë shqiptarëve në aset në funksion të një partie(pjese) të shqiptarëve.

Nisur nga këto vuajtje treçerek shekullore, nuk kuptohet aspak se pse një minorancë artistësh që me vetmohim të nivelit të lartë janë strapacuar duke bërë artin e tyre në kushte ç'njerëzore, ata vetë por edhe gjeneratat e shkuara që prej 1945, nuk u ngritën kurrë për të drejta që lidhen me veçantinë e punës së tyre mes të cilave spikat dhe cilësia e ambienteve të punës krijuese. Shqipëria për fatin e keq ende sot nuk ka as edhe një sallë të vërtetë teatri, përfshi dhe sallat e rikonstruktuara vitet e fundit, në raport me standartet arkitektonike, urbanistike dhe teknike të cilat janë parametër i fiksuar nga praktika e evolucionit të sistemit teatror të botës së lirë prej shekujsh tashmë. Sot po manifestohet një protagonizëm i disa artistëve shqiptarë të cilët në emigracion përballen me mungesa dhe trauma të mëdha identitare duke punuar jashtë fushave të tyre të kompetencës. Siç rrëfente para pak kohësh artisti Leka Bungo i kthyer nga SHBA, në emigracion artistët shqiptarët u morrën me çdo punë por jo me art duke kuptuar pak ose asgjë nga sistemet kulturore të vendeve ku emigruan. Në Shqipëri vijnë dhe krenohen me suksese imagjinare në perëndim, me qëllim përfitimin e fondeve posteve apo dhe famës të cilën nuk patën kurfarë aftësie ta bënin në vendet pasaportat e të cilëve mbajnë në xhep. Aq më pak kuptohet përse shumë artistë të veshur herë pas here me pushtet legjistlativ e egzekutiv, nuk luajtën asnjëherë gishtin për të përmirësuar kushtet e punës apo për të ngritur një sistem të vërtetë autonom perëndimor për Teatrin por edhe për të gjithë zanatet e arteve.

Përse sot edhe kjo protestë shkon në drejtim të paditur, pikërisht në atë drejtim që i intereson politikës për të mbajtur në hije paaftësinë por edhe dashakeqësinë e saj 75 vjeçare ndaj artit dhe kulturës. Përse po kthehet në modë në shqipëri që protesta shoqërore të domosdoshme shkojnë në drejtimin e paditur të shfrytëzimit politik?! Në nëntor 2018, studentët e universiteteve shtetërore u ngritën në një protestë fare jo llogjike kundër Ligjit të Arsimit të Lartë, i cili për herë të parë në Shqipëri i ktheu Universitetet nga shtetërore në publike. Në vend që të protestonin ndaj keqadministrimit dhe korrupsionit kompulsiv të drejtuesve dhe administratave universitare, u përdorën dhe u ndotën pikërisht nga këta të fundit në mënyrë që përgjegjësia e shpartallimit të Universiteteve shqiptare të faturohej tek qeveria dhe këta mjeshtra të kontrollit rotativ korruptiv të vazhdonin kapjen tashmë 30 vjeçare të universiteteve nga maja e mediokritetit, paaftësisë dhe korrupsionit të tyre ende të pandëshkuar.

Artistët shqiptarë, sot më shumë se kurrë kanë nevojë për dinjitet në raport me veten, me tjetrin por dhe me shtetin. Jo vetëm për kushte cilësore pune por edhe për sistem social, ekonomik dhe financiar të mirfilltë. Teatri Kombëtar nuk është një sallë. Drejtori i Teatrit Kombëtar nuk është pronar apo administrator salle. Trupat dhe ekipet teatrore nuk mund të punojnë tre muaj për të përgatitur një shfaqje e cila shfrytëzohet 10 ditë dhe pastaj harrohet. Teatri Kombëtar është i kombit. Ai duhet të qarkullojë shfaqjet e tij në të gjithë Shqipërinë por edhe në shtetet fqinje ku më shumë se gjysma e kombit tonë jeton. Një pjesë e mirë e recetave financiare duhet duhet të administrohet nga vetë Teatri, biles dhe një pjesë e taksave shtërore të arkëtuara nga shfrytëzimi i veprave teatrore gjithashtu.

Teatri kombëtar duhet të jetë një strukturë autonome dhe tentakulare duke organizuar punën me qarqet dhe me fqinjët në mënyrë sistematike. Teatri kombëtar duhet të jetë vetë sistemi kapailar i formimit dhe kualifikimit të brendshëm nën shembullin perfekt të Komedisë Franceze tashmë 300 vjeçare e cila posedon disa salla dhe herë mbas here edhe i ndërron apo edhe sistemeve analoge Gjermane, Britanike apo dhe Italiane. Ndaj sot është koha që artistët të mos keqpërdoren më nga politika e cila vetëm duhet t'u shërbejë që ata të mund të bëjnë atë që dinë të bëjnë më mirë. Në vend se t'ju këkojnë llogari atyre që po përpiqen të bëjnë, për herë të parë në 75 vjet, më të mirën për të gjetur zgjidhje të plota dhe win-win (vetëm të fituar) të kthejnë sytë e përgjegjësisë ndaj atyre që bënë keq ose nuk bënë asgjë sa ishin në pushtet. Dhe lista e këtyre të fundit në 75 vjet është tepër e gjatë. Në të bëjnë pjesë dhe njerëz me lidhje të forta familjare me artin dhe me teatrin në veçanti. Toka e teatrit, ku në 75 vjet arti u krijua art në kushte ç'njerëzore është e shenjtë. Teatri aktual është prova kokfortë e turpit ku e zhyti politika injorante shtërore, artin teatror që lindi në antikitet pikërisht diku në këto troje. Në Teatrin e ri të ngritur mbi këtë tokë të shenjtë patjetër duhet të ketë një hapësirë muzeale të dedikuar, ku veç kryeveprave të krijuara nga artistët tanë të mëdhenj ndërvite të ekspozohen patjetër edhe copëza të turpit strukturor, moral, politik e kulturor ku u reduktua Teatri Kombëtar shqiptar, sidomos në vitet e të ashtëquajturit tranzicion nga një e keqe në tjetrën.

Gjysma zgjidhje apo zgjidhje me një dorë kulaçin me tjetrën kërbaçin si qëmoti nuk duhet të ketë më. Kjo protestë e energji e shpenzuar një vit e gjysëm për tallshin, algat dhe vinovilin e vuajtjes 75 vjeçare të artistëve të Teatrit Shqiptar ngjan më shumë me reagime nën sindromën Stokholmit apo më mirë të themi me personazhin e Llukan Burgamadhit tek Kronikë në Gur e të madhit Kadare. Llukani sa herë që mbyllej burgu nga ndërrimi i pushtuesve, merrte dyshekun e qelisë mbi kurriz e qante rrugëve. Sapo rihapej burgu nga pushtuesi i rradhës shkonte e paraqitej vetë.

Paradë
FJALËKRYQESH

FJALËKRYQI
PA SKEMË

DUHET TË NXINI **36** KUTI

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17
1																	
2																	
3																	
4																	
5																	
6																	
7																	
8																	
9																	
10																	
11																	
12																	

HORIZONTAL
1. Janë zona të kufizuara.
-U shkrua nga Kipling.
-Në fund të pritjes
2. Fiorucci i modës.
-Lumi i Bernës.
-Mund të jetë i kondicionuar.
3. Një koincedencë.
-Kalimi në ekstreme.
-Mbreti i... francezëve.
4. Një raketë europiane.
-Crusoe i Defoe.
5. Pritet në kufij.
-Fillojnëromanin.
-Qe perandoria e... Justinianit
6. Diftong në dietë.
-Janë kundërshtarët e idealistëve.
7. Janë aktivistë të partisë.
-Mbyllin takimin.
8. Janë fushat... sportive.
-Takat pa ekstreme.
-Unë dhe ti.
-Fillojnë titrat.
9. Një çiklist në velodrom.
-Fundi i një fundi.
-Mendes regjisor.
10. Është princ arab.
-Ringrihen nga kreu.
-Është fiksimi.
11. Tri të parat në atletikë.
-Janë lajmet e bujshme.
12. Fillojnë poshtë.
-Qe kampion i tenisit.

VERTIKAL
1. Një intensive me ilaçe.
-Një tip për Fred Astaire.
2. Qe Porta e Divanit.
-Inicialet e Presley.
-Qedër ditore.
3. Dino regjisor italian.
-Satelit i Uranit.
4. Një club me ingranazh.
-Janë të ndryshme në resme.
5. Brian i Roxy Music.
-Kanë lindur nga prindër të racave të ndryshme.
6. Ela e famshme e tenisit.
-Nuk mungojnë në xhami.
7. Zanore oazi.
-Një artiste me tutu.
8. Inicialet e Redford.
-Mund të jetë fetar.
-Inicialet e Seagal aktor.
9. Emër vajze.
-Tre asa.
10. Fillojnë tatëpjetën.
-Janë kasollet.
-Charles Mingus.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

	O	L	I	V	E	R	H	A	R	D	Y		C	A	R	L
A	R	E		A				D	I	E	L	L	O	R	E	
M	A	R	C		H	A	S			B		O	H	A	R	A
A	R		A	V	E	N	T	U	R	I	E	R	E	T		S
L		F	R	A	N	K	E	N	S	T	E	I	N		S	F
G	J	E	O	G	R	A	F	I	K	E		S		S	T	A
A	E		L	O	I	R	A			T	D		S	T	I	L
M	A	S	E	N		A	N	N	A		A		M	O	N	T
A	N	T		I	T			E	M	I	L			A	G	I
T		A	R		O		G	R	E	V	I	S	T			
	T	R	A	I	N	E	R	E		A	L	A	R	M	E	T
L	I	T	T	L	E		I	U		N	A	S	T	A	S	E

11. Përdoret kundër malarias.
-Ripa pa kufij.
12. Janë në skenë.
-Christian në modë.
13. Edukatori i Dionisit.
-Në mes të një kanali.
14. Janë katolikë të Libanit.
-Gjysma e maskës.
15. Norah kantautore.
-Gjysma e sallës.
16. Veriu pa kufij.
-Ishin gjigantë si Hiperioni.
17. Qendër mësimi
-Është si shkatërrim.

HOROSKOPI

DASHI
Gjate kësaj dite do dini t'i përçoni partnerit energji pozitive dhe marrëdhënia me te ka për te qene e jashtëzakonshme. Nuk do e mbani mendjen tek mosmarrëveshjet e se shkuarës, përkundrazi do iu vini njëherë e mire kapak atyre. Situata financiare do jete goxha e mire ne përgjithësi. Gjithsesi ju duhet te vazhdoni te tregoheni te kujdesshëm për ta mbajtur sa me gjate këtë gjendje.

DEMI
Dite mjaft harmonike ka për te qene kjo e sotmja për ju te dashuruarit. Do dini ta mahnitni partnerin dhe marrëdhënien tuaj kane për ta pasur zili te gjithë. Beqaret do tërhiqen shume nga dikush, por nuk do arrijnë dot t'ia shprehin ndjenjat. Me mire te reflektojnë dhe pak e te binden plotësisht. Sektori i financave nuk do ndikohet nga asnjë planet dhe çdo gjë do varet nga mënyra sesi ju do i menaxhoni te ardhurat.

BINJAKET
Venusi do e privilegjoje jetën tuaj ne çift gjate kësaj dite dhe marrëdhënia me partnerin do përmirësohet jashtëzakonisht. Mund te ndani se bashku edhe disa sekrete te vjetra. Beqaret do jene me shume fat ne dashuri dhe as vete nuk e kishin imagjinuar ndonjëherë se sa mire mund t'iu ecnin gjerat. Edhe sektori i financave do jete i privilegjuar dhe nuk do gjendeni aspak ne vështirësi.

GAFORRJA
Dite e favorshme për dashurinë dhe projektet ne çift. Mes jush dhe partnerit do kenë një kimi për t'u pasur zili, madje do harrohen edhe shume hatër mbetje. Beqaret me mire le te presin edhe pak kohe para se te hedhin hapa sepse sot nuk është dita e duhur. Ne planin financiar mos u tregoni te pamatur sepse problemet do ju shumëfishohen. Do ndiheni vërtet keq me pas.

LUANI
Nuk është nevoja te qaheni aspak gjate kësaj dite sepse partneri do dije t'iu përkëdhelë dhe t'iu mbaje ne pëllëmbë te dorës. Te tille dashuri nuk keni përjetuar deri me sot. Beqaret duhet te joshin me mase dhe ne momentin e duhur. Vetëm ashtu kane për te filluar lidhjen e ëndërruar. Ne planin financiar do ju dalin probleme te vogla, por te menaxhueshme.

VIRGJERESHA
Lumturia dhe begatia do mbizotërojë gjate gjithë kohës për ju qe jeni ne një lidhje. Partneri do dije t'iu beje te qeshni ne çdo çast dhe zemra do ju rrahe fort. Beqaret me ne fund mund te ndeshen me personat e duhur dhe mund te fillojnë lidhjen e ëndrrave. Plutoni do jete planeti qe do ju ndihmoje ne planin financiar dhe do ju beje te ruani gjithë kohës qëndrueshmërinë.

PESHORJA
Here pas here do jeni ne tension ju te dashuruarit dhe mund te thoni gjera te gabuara. Mundohuni qe gjithmonë te vini arsyen para ne mënyrë qe te mos e prishni atmosferën e ngrohte. Beqaret nuk do e kërkojnë me ngulm dashurinë sepse edhe ashtu si janë ndihen mire. Buxheti do jete i kënaqshëm kështu qe mund te kryeni pa frike edhe ndonjë investim me tepër nga zakonisht.

AKREPI
Marrëdhënia me partnerin do jete tej mase delikate sot. Do i besoni verbërisht miqtë dhe fjalët e këqija qe ata do thonë për partnerin. Beqaret nuk do arrijnë dot te fillojnë një lidhje afatgjate, megjithatë do pranojnë te shoqërohen me dike qe i bën te ndihen te qete. Me shpenzimet tregohuni te arsyeshëm nëse nuk doni qe situata te marre tatëpjetën.

SHIGJETARI
Marrëdhënia juaj ne çift do vihet para provave te vështira sot. Po i kaluat te gjitha problemet qe do ju dalin keni për te pasur një jete te begate. Beqaret duhet t'i shprehin ndjenjat ashtu si t'i kenë ne zemër, por kurrsesi nuk duhet te cenojnë disa parime vetëm për te filluar një lidhje. Buxheti me ne fund do ekuilibrohet goxha dhe do ndiheni me te qete kur te kryeni shpenzimet e domosdoshme.

BRICJAPI
Klima yjore do jete shume e ngrohte sot për ata qe janë ne një lidhje. Ata do kalojnë momente te mrekullueshme pranë personit qe duan dhe do i falënderojnë gjithë kohës yjet. Beqaret duhet te marrin kohen e duhur për t'u njohur me disa persona para se te vendosin te hedhin hapa te mëdha. Ne planin financiar vështirë se gjendja mund te jete e qëndrueshme pas gjithë shpenzimeve te pamatura qe keni kryer se fundmi.

UJORI
Po u treguat te sinqerte dhe po ia shprehet sa duhet dashurinë partnerit, marrëdhënia me te ka për te qene e jashtëzakonshme dhe askush nuk do arrije t'ua prishe harmoninë. Beqaret do favorizohen nga te gjithë planetët dhe me shume mundësi do e fillojnë lidhjen qe kishin ëndërruar prej kohesh. Buxheti do jete problematik dhe vetëm me mbështetjen e familjareve do mund t'ia dilni mbanë.

PESHQIT
Do jeni xheloze për partnerin tuaj gjate kësaj dite dhe nuk e lini asnjë moment te lire. Kujdes sepse kjo gjë mund ta mërzitë atë dhe mund ta largoje akoma me tepër. Beqaret do bëjnë mire te mos nxitohen për asgjë sepse mundësitë me te mira do iu jepen pas disa ditëve. Buxhetin për fat do dini si ta menaxhoni gjithë kohës dhe gjendja ka për te mbetur e kënaqshme.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGA 1 9

2		4			9		5	1
8	3		1	4		9	7	
	1				3			2
1		3		5			4	
	8		7		4		1	
	6			3		8		5
3			4				6	
	4	1		8	5		9	7
7	9		2			5		4

PËRGJIGJE

3	2	7	5	1	9	4	6	8
1	8	5	3	6	4	9	7	2
4	6	9	8	7	2	1	5	3
5	9	3	2	4	6	8	1	7
6	4	1	7	8	3	5	2	9
2	7	8	9	5	1	3	4	6
7	1	4	6	3	8	2	9	5
9	3	6	4	2	5	7	8	1
8	5	2	1	9	7	6	3	4

FJALËKRYQI SPORTIV



		1		2			3		4	5	6		7	8	9					
						10			11											
			12		13			14						15						
		16								17		18	19							
20	21		22						23						24					
	25	26					27		28											
		29				30		31			32									
33	34			35	36		37													
38		39	40							41	42									
43																				

HORIZONTAL
1. Agolli futbollist.
4. Një lidhëz
7. Johnson që qe atlet i famshëm.
10. Fillojnë metodën.
11. Hingis ish-teniste.
12. Është mbrojtës i Inter
15. Ruhet në fund
16. Cristiano te Juventus.
17. Vriten nga espada
20. Një yll i skuadrës.
22. Domenico te Sassuolo.
23. Boja në printer
25. Rooney bomber anglez
27. Mbyllin takimin.
28. Diego... Maradona
29. Fillojnë aksionin.
31. Fillojnë nazet.
32. Ka rivale Mediaset
33. Kufizojnë rastet
35. Ka dalë kampion
38. Mbrojtësi në foto
41. Lemond ish-kampion i çiklizmit
43. Mesfushori në foto

VERTIKAL
1. Mbyllin fushatat
2. Është sezon.
3. Është livadh.
4. Pak amatoriale
5. Fillojnë matanë
6. Qe bomber i paharruar i yni
7. Kështu fillon biseda
8. Mundn të jenë komunikuese
9. ... King Cole
10. Paolo, ish as- i Milan
12. Thomas i Utopia
13. Me të nxjerrin trarë
14. Fillojnë dobët
16. Tri të parat në renditje
17. E mbledhur është grusht
18. ... culpa siç bën ai që pranon fajin
19. Gjysmë arnimi
21. Të parat në swing
22. Është kashta
23. Pishtarë pa pishë
24. Stop and... penalite në Formula 1
26. Dy asa
30. Gareeth mesfushor uellsian
33. Norma... e Marin Ritt
34. Tenor pa zanore
35. Çifte për killer
36. Gjysmë piloti
37. Ruajnë pa ujë
39. Dean Martin
40. Dy romake
41. Kufizojën gjahun
42. Qendër kurimi

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

FJALEKËRYQI
I KRIPTOGRAFUAR

10		4	6	2	4	6	11	1	3		4	1
19	5	1		2	1				1	4	5	12
6	5		4	8	2	13	1	7	7	1		1
2		12	1	4	11	8	3	5	9	8		
3	2	8	4	14	8	10			10	7	1	12
5	2		1	7	2		1	3	16	5	11	1
11	15			7		9		9	6	9	1	3
4	8	2	5	6	11	5		6	17	8	11	
	13	8	2	2	5	18	9				5	3 T
3	16	1	3	8	10	5	2	1		2	1	6 O
1	1	7			15		1	2	1	3		4 G
10	7	8	7	7	1		16	1	7	7	9	1 A

PËRGJIGJE



SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP** ; Aurel PEPA ***KRYEREDAKTOR***
Patricia COSTANTINESCU ***ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME*** ; Admirina PEÇI ***KRYEREDAKTORE E "RILINDASI" ;***
LAYOUT DESIGN : Altin ALIAJ, ***SHPËRNDARJA:*** Spiro MESHINI ***CEL:*** +355696088847

Departamenti i Marketingut: Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419 - ***marketing@shqiptarja.com***

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. ***E mail:*** shqiptarja.com@hotmail.com ***Website:*** www.shqiptarja.com ***Mobile:*** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

VENDE UNIKE PËR TË VIZITUAR!
THE MOST UNIQUE PLACES TO VISIT!

BUNK'ART 1

- Ekspozita video-muzeale e periudhës së komunizmit në Shqipëri e ndërtuar brenda bunkerit anti-bërthamor të Luftës së Ftohtë

- The video-museum exhibition of Albania's communist era build inside the anti-nuclear bunker of the Cold War

Ku ndodhet BUNK'ART 1?
Rr. Fadil Deliu
(afër teleferikut) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 16:00 *të hënë & të martë pushim*

BUNK'ART 2

- Ekspozita e parë video-muzeale e ndërtuar në kujtim të viktimave të terrorit komunist

- The first video-museum exhibition built in memory of the victims of the communist terror



Ku ndodhet BUNK'ART 2?
Rr. Abdi Toptani
(përballë Bashkisë) - Tiranë

ORARI: 09:00 - 18:00 *çdo ditë*

www.bunkart.al / info@bunkart.al
Prenotime / Reservations: +355 (0) 67 20 72 905